

Procesverbal

Nga Mbledhja XI (e njëmbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 18.12.2024

Rend Dite

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
01 Nr. Br. 06/01-31/085/24
27.01.2025
Dragash - Dragash

- 1) Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
- 2) Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2025;
- 3) Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të QKMF-së;
- 4) Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për pagesën e komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës;
- 5) Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit;
- 6) Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit;
- 7) Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ZK Dragash P-70604014-00099-1 me pronën e përbashkët të z.Amir (Ahmet) Jamini, z.Asad (Ahmet) Jamini, Rehjan (Omer) Jamini dhe Nerkes (Omer) Jamini, prona me numër të parcelës P-70604014-00827- 2 ZK Dragash;
- 8) Diskutim për Raportin e Performancës Komunale; dhe
- 9) Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje për të gjithë kolegët, të pranishmit, mediat dhe të gjithë qytetarët që po na përcjellin! Mirë se keni ardhë në seancën e 11-të të rregullt (e dymbëdhjeta me radhë) për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë Në këtë seancë kemi shtatë pika të rendit të ditës dhe pikën eventuale, siç e keni pranuar në ftesë. Mirëpo, pas dërgimit të ftesës ju ka ardhë një propozim me materialin për shtesën e një pike të rendit të ditës që ka të bëjë me performancën. Para se ta qesim në votim, rendin e ditës, a do dikush me e marrë fjalën?

Shpetim Hajredini: Përshëndetje, të nderuar pjesëmarrës! Ndoshta ka qenë faji im që ky material i kësaj pike nuk ka ardhë në emailin tim. Nuk po e di nëse mungon edhe te ndonjë asambleist tjetër, por mu nuk më ka ardhë në email dhe nuk di edhe çka të diskutoj për këtë pikë të rendit të ditës. Prandaj unë kisha kërkue, nëse është e mundshme, tani të më silllet, jo vetëm mua personalisht, por të gjithëve, në formë fizike nëse keni mundësi, që se paku unë ta lexoj deri në përfundim të seancës,

e kena ndoshta pikën e fundit këtë diskutim për Grantin e Performancës, dhe pastaj ta di se çka muj me diskutue. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Atëherë po, kjo ka mundësi të bëhet. A jeni dakord që ta fusim këtë në rend të ditës, dhe materiali besoj që ju vjen për pak. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës me pikën shtesë për performancën e Komunës. Atëherë, fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara. Kush do me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2025. A do dikush me a marrë fjalën?

Driton Ademi: Përsëndetje për të gjithë! Kishte qenë mirë, unë edhe disa seanca tjera kam kërkuar që pikat e rendit të ditës të cilat vijnë të sponzorizuara nga qeverisja, drejtorët me dalë këtu edhe me i sqarue paraprakisht. Besoj që drejtori i Financave po ashtu. Drejtor, mos gabofsha sot është e treta seancë për shqyrtimin e Vendimit për shpalljen e listës së përgjithshme dhe të veçantë. Jam duke kërkuar që mos me na i pru me kode, po me na i pru me lokacione ku janë. Unë e di që nashta ka punë për me i pru me lokacione, por për shkak se qytetarët nuk janë duke e ditë vendndodhjen, është mirë – edhe seancave tjera kam kërkuar, po edhe sot po kërkoj – që këto me na i pru me vendbanime ku janë, jo vetëm me kode. Unë e kuptoj, ata të cilët e përdorin internetin, kanë qasje edhe dijnë për me u kyç, unë e di që mujn me i gjet këto kode. Por është mirë që këto kodet që i ke pru këtu, me i pru me vendndodhje ku janë. Qat filan kodin ku e ke shkruar, vizë ku është fshati, për shembull Bresanë, Dragash, Bellobrad, Zaplluxhe e kudo që të jetë. Herën e fundit më ke thënë që duhet pak punë, po besoj që është mirë që qytetarët me qenë të vetëdijshëm, ku janë këto prona, me i ditë përafërsisht. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Përsëndetje për të gjithë! Pyetja është plotësisht e qartë, mirëpo mbrapa në kolonë lokacionet janë të shkruara – shkruan: Bresanë, Blaç, Vraniç, Lloposhnik, Restelicë... kqyre kolonën e fundit dhe e ke vendin. Janë në listën e parë të Dragashit, për arsye se kështu janë në bazë të regjistrimit në statistika. Të dhënë më tepër nuk jepen për shkak të ruajtjes së privatësisë, mirëpo të gjitha këto lokacione janë shumë lehtë të kuptueshme se në cilin vend janë. Prandaj, në bazë të ligjit, janë të parapara këto regjistra me të dhënat të cilat duhet t'i japim. Prandaj, çdo gjë që lypish ma tepër, unë besoj që është e jashtëligjshme. Ti ke të drejtë, është mirë, ne e dimë që

dikush edhe i ka të kontraktuara këto, mirëpo iu skadon afati, jemi të detyruar që këtë vit ta parashohim për vitin tjetër me i dhënë mundësi dikujt tjetër për me i marrë në shfrytëzim. Prandaj, në qoftë se i analizojmë mirë, unë besoj se ka të dhëna të mjaftueshme për secilin qytetar, të orientohet shumë drejt në qoftë se është i interesuar për me shfrytëzue një pronë komunale.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 22 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e radhës: Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të QKMF-së. T'ia japim fillimisht fjalën drejtorit të Shëndetësisë, pastaj do ta merrni fjalën ju asambleistët.

Behar Brenoli: Selam alejkum, i nderuari kryetar, kryesuese, delegatë, më vjen keq që e kemi përsëri të njëjtën pikë të rendit të ditës, megjithatë, nëse e keni ndjekur materialin që keni marrë, në seancën e fundit kur vendimi është kthyer për shqyrtim për herë të parë, Ministria na dha 10 rekomandime që duhej t'i kishim zbatuar. Pasi i kemi zbatuar këto rekomandime, tani ka ardhur një rekomandim i ri me dy propozime të tjera. Nëse shikoni me kujdes, do të shihni se këto rekomandime nuk përputhen, sepse këto dy rekomandimet e fundit ishin në rregull për Ministrinë e Shëndetësisë herën e kaluar dhe nuk janë tani, kështu që nuk është faji ynë. Ose nuk e kanë bërë siç duhet detyrën herën e fundit ose është bërë me qëllim. Rekomandimi numër 1 është i njëjtë, neni numër 1 është i njëjtë si në formën e unifikuar të statutit. Nuk e di pse e kanë dërguar këtë rekomandim. Në rekomandimin numër 2, neni 13, paragrafi 4.2, shkruhet se është i harmonizuar me Statutin. Që në seancën e parë kur diskutuam për Statutin, thamë se çdo ndryshim që bëjmë rrezikon që Ministria t'i kthejë ato tek ne. Ne kemi bërë ndryshime në nenin 13, pika 4, ju keni që në material, ne nenin 13, pika 4, kemi shtuar se QKMF-ja ka një zëvendës drejtor, kemi saktësuar se nga komuniteti shumicë dhe joshumicë, Ministria ka kthyer. Na kërkojnë ta rregullojmë. Ata nuk i pranuan ato ndryshime. Unë personalisht jam për këtë çështje, duke qenë se më shumë se 40% e komunitetit joshumicë jeton në Dragash. Megjithatë, Ministria nuk e pranon këtë. Duke vepruar kështu, rrezikojmë të na kthehet Statuti. Ne e diskutuam këtë me kryetarin e komunës, gjetëm modalitete të tjera që ai mund t'ju shpjegojë më vonë, për të mbrojtur komunitetet joshumicë. Përsëri ju bëj thirrje që ta votoni këtë Statut me këto rekomandime, përndryshe rrezikojmë që Statuti të kthehet për shqyrtim.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues! Të nderuar asambleistë, mjete të informimit dhe ju qytetarë! Nuk dua t'i përsëris arsyetimet të cilat i dha drejtori i Shëndetësisë, vetëm dola këtu t'ju vërtetoj se në dy seanca para kësaj ne e kemi shqyrtue Statutin e QKMF-së, dhe me propozim të komunitetit joshumicë e kemi ndryshue Nenin 12. Atë ndryshim të cilin e kemi bërë, e kemi bërë me vullnetin tonë. Me sa e di unë, këtë të gjithë asambleistët e kanë votue, dhe të gjitha partitë të cilat e përbëjnë Asamblenë. Ju keni treguar një vullnet që, nëse në QKMF-Drageash drejtori është i komunitetit shumicë, atëherë zv/drejtori duhet të jetë i komunitetit joshumicë. Mirëpo, duke marrë parasysh se ky ndërrim i Nenit nuk përkon me Statutin i cili është në fuqi në të gjitha QKMF-të e Kosovës, atëherë, faktikisht Ministria e Shëndetësisë na ka kthye këtë si ndryshim i paligjshëm dhe na ka rekomandue që këtë Nen ta heqim. Unë dola këtu që t'jua rikonfirmoj, se unë e kam vullnetin ta bije një vendim dhe ta obligoj drejtorin e Shëndetësisë dhe atë të QKMF-së, që në rastin e përzgjedhjes së zv/drejtorit, të zgjidhet nga komuniteti joshumicë. Me një vendim të kryetarit kjo mund të rregullohet, ndërsa ju, të nderuar delegatë, duhet që t'i votoni rekomandimet, për arsye se është një rekomandim që duhet ta zbatojmë, dhe dëmet janë të mëdha për Komunën nëse këtë rekomandim ne nuk e zbatojmë. Njëra prej tyre është se MAPL-ja mundet me e çue lëndën në gjykatë, dhe në këtë rast shkojnë në gjykatë edhe kryetari edhe kryesuesja. Dhe, e dyta është që mundemi me e hup Grantin e Performancës për vitin 2024, për arsye se, nëse ne vendimet e MAPL-së i kundërshtojmë dhe nuk i zbatojmë, atëherë janë ato katër kriteret kryesore, në bazë të të cilave Komuna mundet me u kualifikue për Grant të Performancës. Kështu që, unë i kisha lut delegatët që këto dy rekomandime që i ka dhënë Ministria t'i aprovojmë. Mirëpo unë, pasi të përfundojë Asambleja Komunale, do ta shtypi një vendim dhe do të kërkojë nga drejtori i QKMF-së që në rastin e zgjedhjes së zv/drejtorit, ta emërojë atë nga komuniteti joshumicë. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: I nderuar drejtor, po më pëlqen që mënyrën e përshëndetjes e ke më të mirën të mundshme, se na tjerët s'kena guxim me thënë selam alejkum, ne thona përshëndetje. Ndërsa, sa i përket Statutit të QKMF-së, ne e kemi diskutue edhe në dy seancat e kalume, dhe në seancën e fundit, nëse ju kujtohet, thashë që ishalla do Zoti e nuk e keni bo naj lëshim. Po doli që prapë keni bo lëshim. Ne kemi qenë pro edhe në atë seancë dhe natyrisht që do të jemi pro prapë edhe në këtë seancë. Për dokumente të rëndësishme nuk e diskutojmë çështjen e votimit. E dëgjova me vëmendje drejtorin, por ndoshta përkthimi nuk ishte shumë i kapshëm për mu dhe për atë edhe vendosa ta marr fjalën dhe ta them mendimin tim në lidhje me këto dy nene ku kanë ardhur

rekomandimet tani prapë nga Ministria. Nenin i parë – e kam bo një krahasim me dy statutet e kalume – statuti i parë dhe statuti i dytë në Nenin e parë janë të njëjtë, tani e keni bo ndryshimin, kjo po i bjer që Ministria është fajtores, nuk jeni ju fajtorë, se ata është dashtë ta japin rekomandim tek statuti i parë që të përmirësohet ky Nen. Pra ju nuk jeni fajtorë për këtë Nen. Ndërsa, sa i përket Nenit 13, që na kanë dërgue ata të Ministrisë që ta përmirësojmë, natyrisht është bërë përmirësimi këtu në seancë dhe na këtë e bëmë së bashku. E shtuam dhe e ndryshuam këtë Nen. Dhe, doli që nuk është në rregull. Ajo që po dua të them përfundimisht, është duhet gjithmonë ta keni parasysh ligjin dhe të mos mundohemi ne këtu në Komunën tonë t'i plotësojmë dëshirat apo teket e dikujt, sepse po e pësojmë na. Po na kthehet tri herë, kjo nuk është në rregull dhe më e rëndësishmja është që ne nuk po mbushemi mend. Andaj, po shpresoj se vendimet e ardhshme do të bazohen në ligj dhe nuk do t'i ndryshoni ashtu siç po keni dëshirë ju. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Ajo që më shqetëson është se dy herët e mëparshme keni pasur akses ekskluziv në këtë Statut. Nuk e dëgjuat fare opozitën. Ju kishit votat dhe kohën për ta përgatitur këtë, nuk mund të pranoj që t'ua lëmë fajin ministrive. Ky është leximi i katërt i Statutit në Kuvend. Unë ju tregova se Ministria do të na kthen Statutin. Nëse ka ligje dhe UA, do të thotë që drejtori duhet ta marrë më seriozisht hartimin e Statutit, që të mos na kthehet në Kuvend. A duhet të presim që të mos kemi një Statut deri në fund të mandatit? Problemi i dytë është se nuk na dërgoni përgjigjet e Ministrisë në material, por ne duhet t'ju besojmë, une nuk ju besoj. Praktika ka treguar në këto tre vite që nuk po thoni të vërtetën. Prandaj, ju lutemi na dërgoni vendimet e Ministrisë në material. Të shohim ku ka gjetur gabime Ministria, kështu e shoh unë fajin tek Drejtoria e Shëndetësisë. Leximi i katërt është i çuditshëm për mua. Ndoshta hera e parë donim të përfshinim një zëvendësdrejtor nga një komunitet jo-shumicë, por 4 herë të tjera fajin e keni ju. Ju keni detyrimin të sillni një Statut cilësor në asamble. Drejtori është i obliguar të hartojë Statutin në pajtim me ligjet në fuqi. Drejtori duhet të fokusohet pak më shumë në punën e tij sesa tenderat. Nëse nuk e dini, kërkon asamblenë t'ju ndihmojë, por ne nuk mund t'ju ndihmojmë ndërsa ju shpërfillni sugjerimet tona. Në vendet normale të Evropës Perëndimore, nëse një person dështon tre herë në testin e shoferit, ata e dërgojnë atë te një psikiatër. Ne kemi një status që na është kthyer 4 herë dhe plus ju keni punësuar një psikiatër në QKMF përmes Human Care, ku është ai, a mund të kalohet një klasë në një shkollë me 4 njisha. Është për të ardhur keq që Kryetari krenohet me këtë drejtor dhe ai vetë vjen nga fusha e mjekësisë. Ky është kapitullim për ju. Kam degjuar qe

kemi shabllon per Statutin, si ka mundesi te behet gabim ne shabllon. Kjo dëshmon mungesën e seriozitetit tuaj.

Bexhet Xheladini: Nuk dashta me ju lodhë, por pasi m'u përmend disa herë emri, dua të jap disa sqarime. Nuk është katër herë që është kthye Statuti, është hera e dytë. Herën e parë i kemi marrë dhjetë rekomandime – në seancën para kësaj, të fundit – dhe QKMF-ja, drejtori i QKMF-së dhe drejtori edhe stafi i QKMF-së, të gjitha këto rekomandime që i ka lyp Ministria – e keni materialin, nuk është e vërtetë që rekomandimet e Ministrisë nuk jua kemi çue, të dyja i keni, edhe të parafundit edhe të fundit – në këto dhjetë rekomandime nuk janë të përfshime dy rekomandime që i kanë gjet tash herën e fundit që e kanë kthye. Unë nuk po them që Ministria e ka bërë me tendencë ose ka faj, por ndoshta edhe nuk i kanë vërejt ato nenet të cilat janë të harmonizuara me Statutin. Ose është edhe me tendencë, nuk e di. Kështu që, kjo është hera e dytë, jo hera e katërt, edhe ne jemi të obliguar që këto rekomandime që vijnë me i qit në Asamble, edhe Asambleja me i miratue, sepse janë rekomandime të cilat janë antiligjore dhe duhet me qenë të harmonizuara me Statutin Unik që është për të gjitha komunat e Kosovës. Faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderuar të pranishëm! Kemi diskutue vazhdimisht për këtë Statut të QKMF-së. Realisht, jo që dashta me e marrë fjalën, mirëpo edhe dje në Komitet kryetari tha që Ministria i ka fajet. Tash unë ju kisha sugjeruar, edhe drejtorit edhe kushdo që e ka bo këtë Statut, është mirë me i lexue udhëzuesit administrativë, ligjet të cilat janë përkatëse për këtë. Të paktën keni edhe këshilltar ligjor këtu në Kuvend. Me e hek fajin edhe me e dërgue diku tjetër është shumë e lehtë edhe shumë e thjeshtë. Dikur ma herët në një seancë, Artani e përmendi mësuesin. Z.Sef doli edhe e mbrojti këtu mësuesin. Tjetra është që Ministria nuk funksionon me rregulla të pashkruara, qysh jeni mësue ju këtu, edhe me bo statute qysh t'jau do qefi. Mandej tha që nuk është kthye nga Ministria, nashta nuk është bo me tendencë, po na ka dhënë rekomandim. Ministria me çekiç s'të bjer. I tejkalosh normat edhe ligjet, ta kthen prapë, të rekomandon. Kur kthehet prapë, ka rekomandime. Kqyrni rekomandimet, rregullojeni, ne jua mbështesim prapë, por gabimet s'un jau korrigjojmë, se nuk po mundim na me i marrë edhe rekomandimet, thjesht s'po na i dërgoni rekomandimet që na me diskutue edhe me ju dhënë një sugjerim për përmirësim. E, sa herë që mundohnu me punue krye në vete, duke e anashkalue Kuvendin, unë po besoj që prapë kanë me jua kthye ose me ju rekomandue për ndryshim. Ministria qat punë e ka, s'vjen juve me ju mësue këtu edhe me ju mbajt ligjërata edhe udhëzime se si bëhet. Jau dërgon udhëzimet, plotësimet, ndryshimet, varet ju a doni. Por neve s'po na i dërgon, neve veç po na i bjer me i votue, na këtu

ku e dimë të shkretët çka po bëjnë ata, po votojmë ose s'po votojmë. Po e boni 13-shin edhe po mendoni që më atë 13-sh ose 14-sh mundeni me bo gjithçka. Mësuesi është i shenjtë, Artan, ama kur s'di me mësue nxënësin s'ka vlerë. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ndoshta Urani nuk e di që rekomandimet i ka pas në thirrje edhe në pikën e rendit të ditës. Po më vjen keq që para opinionit po duesh me thënë që nuk kemi pas rekomandime. Të isha lut që herën tjetër me i lexue pikat e rendit të ditës, se kreja rekomandimet i ke aty. Mos del këtu me thënë që s'kemi pas rekomandime!

Uran Halimi: Shumë faleminderit, znj.Kryesuese! Realisht mu më vijnë replikat, edhe më bëhet qefi kur më japin kohë për këto replikat. Paskemi marrë herën e fundit mo, a po e dish, për me u arsyetue se u bo hera e katërt. Edhe këtë herën është e katërta me radhë që na diskutojmë për këtë pikë të rendit të ditës, nëse të kujtohet, znj.Kryesuese. E di që s'të pëlqeu ky fjalimi jem, se s'ju pëlqen e vërteta juve, duhet pak ma ju bo rrafsh, e unë rrafsh nuk di me ia bo kërkujt. Është hera e katërt, nëse këtë herë e kemi marrë rekomandimin, më kallxo për nja tri herë tjera, a i kemi pas rekomandimet. Sa i përket me e lexue materialin, unë znj.Kryesues shumë mirë e lexoj edhe e hulumtoj. Faleminderit shumë, edhe për rekomandimin tuaj, do ta kem parasysh!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Edhe herave tjera kanë qenë të gjitha rekomandimet. Në qoftë se bash duesh me e ditë, për të gjitha herët që u kthye Statuti i QKMF-së, rekomandimet i keni pas.

Shpetim Hajredini: Çëshjta e rekomandimeve, ndoshta edhe ka pas prej kolegëve asambleistë që nuk kanë qenë pjesë këtu, nuk po e di, por edhe në fjalimin tim përfundimtar të seancës së fundit kam thënë faleminderit ekzekutiv që më në fund e mbajtët djalën edhe shkuat na bazë të ligjit, na i prut rekomandimet. Herën e kaluar, edhe tash, edhe për këtë të fundit që jemi sot duke e diskutue, i ke dy rekomandime...

Arijeta Skeraj: Veç pak, edhe herën e kaluar ka qenë rekomandimi, edhe tash, duhet me ia qit opinionit edhe asambleistit në fjalë, që nuk e lexon ndoshta materialin.

Shpetim Hajredini: Në dy herët e fundit që na është kthye Statuti, rekomandimet i kemi në material. Na kanë ardhur. Dhjetë kanë qenë në Statutin e kaluar, edhe dy i kemi tash në Statutin që sot ne po e diskutojmë me përmirësime, janë edhe dy rekomandime prej Ministrisë. Ajo për të cilën më shumë e mora fjalën ishte fjalimi i kryetarit. Unë – nuk e di, kryetar, sa më dëgjove – ma herët e thashë që, sa i përket Nenit të parë unë personalisht e zë fajtor Ministrinë, edhe pse ju është dashtë të kordinoheni edhe ta merrni formatin i cili është i duhuri dhe i cili është ligjor. Por, pa marrë parasysh, pasi Ministria i kanë dërgue dhjetë rekomandime herën e dytë, është dashtë edhe

të jetë i njëmbëdhjeti tek Neni i parë. Ata nuk e kanë bo, në këtë moment e kanë bo. Për sa i përket Nenit 13 edhe 4.2, edhe 4.1 e ke të njëjtë, e kemi ndryshue na vetë, pra në dy statutet e mahershme ka qenë në rregull, nuk e kemi prek, ndërsa 4.1 e kemi ndryshue vetë na. Edhe kjo doli që nuk është e ligjshme, na ka kthye prapë dhe duhet ta rikthejmë në formën unike, si i takon Statutit të QKMF-së në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Është hera e dytë që na kthen Ministria. Herën e parafundit na i ka pru dhjetë rekomandime, është dashtë me i pru dymbëdhjetë. Rekomandimet e herës së fundit që i ka pru, Ministria është dashtë me i pru herën e kaluar. Tash, ose Ministria nuk i ka pa këto, ose është ndërrue zyrtari që e ka bo shikimin e ligjshmërisë së Statutit. Por megjithatë, ne jemi fajtorë që e kemi ndryshue Nenin 13. Aty është jo faji ynë, por ka qenë vullneti i mirë i yni. Aty është gabimi, për atë edhe na kanë pru dhjetë rekomandime, por është dashtë me i pru dymbëdhjetë herën e kaluar. Na i kemi plotësue rekomandimet, tash kur e kemi çue për herën e dytë, ata kanë pru rekomandime të reja. Kështu që, unë nuk po them që i ka fajet Ministria, por nuk është faji ynë. As i QKMF-së, as i Asamblesë. Ka raste kur ndërrohen zyrtarët në Minsitri, edhe bëhen edhe këso gabime. Kemi pas edhe te pronat më duket një gabim kështu, për PZhK-në. E njëjta na u përsërit. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Problemi me Statutin e QKMF-së qëndron në mospërshtatjen e Statutit që e çon Drejtoria e Shëndetësisë edhe Komuna jonë, me Statutin Unik që është nëpër të gjithë Republikën e Kosovës. Qat Statut duhet me e përshtat edhe me e unifikue me Statutin që është në nivel të RKS-së. Nëse ne dalim jashtë kësaj, atëherë çdo herë ka me na u kthye me rekomandime shtesë. Kështu që, çka mbetet është me dalë drejtori i Shëndetësisë, me iu ulë punës edhe me e përshtat Statutin me Statutin Unik që është në nivel të RKS-së. Tash, pse nuk e bën drejtori atë punë, është problemi i drejtorit. Sa herë të mos e bëjë drejtori punën, ka me na u kthye neve me rekomandime këtu. Kemi me diskutue, kemi me votue edhe kumedit sa herë. Derisa ta përshtate me Statutin Unik që është në nivel të RKS-së. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! As Sejdlarit, as Uranit nuk iu përmend emri. Ju kisha lut, fjalën e keni pas. Shpetimi e ka marrë pasi i ka tregue kryetari për rekomandimet edhe ka dalë ka diskutue.

Munir Jonuzi: Të nderuar Zotërinj, jemi përpara leximit të 3-të ose të 4-t të Statutit dhe duke pasur parasysh se kemi marrë edhe 2 pikë të tjera që duhet t'i përshtatim me Statutin e unifikuar, nuk mund të mos mendoj se dikush po luan me ne këtu. Herën e kaluar kemi marrë 10 pikë që na është dashur t'i shqyrtojmë dhe t'i përshtatemi me Statutin e unifikuar në Kosovë. Kështu bëmë.

Ne i kemi rregulluar të gjitha pikat e diskutueshme. Tani marrim edhe dy pika të reja që duhet t'i rregullojmë, dhe paradoksi është se këto dy pika ekzistojnë në leximin e mëparshëm. Ndaj pyes veten pse nuk na e sollën herën e fundit. Nuk mund ta kuptoj se cili është qëllimi i votës sonë. Cili është qëllimi i miratimit të Statutit të QKMF-se? Na dhanë një Statut të unifikuar për tërë Kosovën dhe neve na pritet vetëm të fusim emrin e QKMF -së, logon, vendndodhjen, pa asnjë diskutim, kritikë, përgjegjësi, pa futur asgjë konkrete, pa futur atë që vlen vetëm për komunën e Dragashit. Nëse nuk përfshijmë asgjë tonën në këtë Statut, atëherë cili është qëllimi i ekzistencës sonë? Ne marrim akte ligjore dhe nënligjore nga niveli qendror dhe askush nuk pret që ne ta vërtetojmë atë. Dhe për këtë akt presin që ne ta vërtetojmë atë unike. Nëse ata presin, atëherë duhet të marrin parasysh disa nga specifikat tona. Ata duhet të marrin parasysh disa nga specifikat tona. Specifikat e komunës së Dragashit. Komuna e Dragashit nuk është unike vetëm që është komuna më e varfër në Kosovë. Komuna e Dragashit nuk është specifike vetëm në atë që ka nivelin më të lartë të migrimit. Komuna e Dragashit është gjithashtu specifike në atë që është shtëpia e numrit më të madh të komuniteteve joshumicë në Kosovë. 40% e popullsisë së komunës është e përbërë nga komunitetet joshumicë. Merrni ndonjë komunë në Kosovë, sigurisht që nuk do të gjeni një raport të ngushtë në mes të komuniteteve shumicë dhe joshumicë. Pse nuk përfitojmë nga kjo specifike e jona? Pse individët e MSH-se kundërshtojnë që ne të fusim nenin 13, pika 4, paragrafi 2. Pse insistojnë në këtë nen, për shkak të asaj që thashë pak më parë? Ju e dini që sipas ligjeve për shërbimin publik në territorin e kësaj komune duhet të punësohen 40% e komunitetit joshumicë. Neni 4 i Ligjit për Shërbimin Publik na thotë se në gjithë Kosovën, në të gjitha institucionet, duhet të jetë 10%, kurse në ato komuna ku është përqindje më e lartë, të ketë përqindje më të lartë të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë. Këtu është 40%. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për punësim, por vetëm për punësim të rregullt. Përkundrazi, bëhet fjalë për emërimin e anëtarëve të komunitetit joshumicë në pozita udhëheqëse. Nëse zgjidhet një drejtor nga komuniteti maxhorancë, le të përfshijmë edhe një zyrtar nga komuniteti joshumicë, ne nuk kemi shkelur ligjin me këtë, pse, sepse kemi kërkuar të njëjtat kushte për zëvendës drejtorin. Herën tjetër, më lejoni të bëj fillimisht një propozim, propozimi im është që neni 13, pika 4, numri 2 të mbetet në këtë statut. Të tregojë vullnetin për të mbrojtur komunitetin joshumicë. Ne jemi këtu për ta mbrojtur atë, në kuvend. Pse, fola për Ligjin për Shërbime Publike, për përfshirje, për përfshirje të komuniteteve joshumicë, për ekuilibër politik. Pozita e zëvendës drejtorit nuk është pozitë politike. Por ne si politikanë duhet ta bëjmë të mundur. Ne duhet t'i tregojmë ministrisë se si është komuna jonë. 40% e komunitetit

joshumicë jeton këtu. Komuniteti joshumicë duhet të jetë në pozita udhëheqëse. Krysuese, propozimi im është që neni 13, pika 4, numri 2 të mbetet në këtë statut dhe ta hidhni në votim. Nuk kam dashur të fajësoj drejtorin me këtë, edhe pse kam një ankesë ndaj tij, të paktën ai mund të kishte kërkuar nga anëtarët e komunitetit joshumicë që të mos lejojnë shfuqizimin e këtij neni nga Statuti. Nëse ai duhet t'i nënshtrohët urdhrave të MSH-së, ne nuk kemi pse. Nëse do të duhej t'i dëgjonim ata, nuk do të duhej ta pranoni këtë. Kur miratohen ligjet dhe rregulloret administrative, askush nuk na pyet, por na pyesin për këtë. Nëse po pyesim, atëherë le të fusim disa specifika tona.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër? Uran, nuk mundem, se e ke pas kohën dhe replikën.

Edin Kurt: Ju pershendes te gjithëve. Për këtë pikë, më duhet të pajtohem me kolegun tim Munir, nëse është Ministria, nuk është Zot. Mendoj se duhet të insistojmë që ky nen të mbetet në Statut. Në fund të fundit, le ta shkruajnë vetë Statutin dhe ta nënshkruanë Kryetari. Kjo është si kur një babë e bir shkuan të blejnë një makinë, kur babai thotë: "Nuk më intereson se çfarë ngjyre është makina, veteem le të jete ngjyre kuqe.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Dr.Jetmir, e ke krye ti, për replikë nuk të ka përmend kërkuar. As z.Sejdilar, as z.Uran. Ju lutem! Shpetimin ia ka përmend kryetari. Atëherë, diskutimet janë krye. Propozimi i Munirit ishte Neni 13, që Ministria e ka kthye prapë. Ne jemi organi më i lartë, nuk mundim t'i shkelim ligjet e Kosovës. Por, ne duhet ta qesim në votim propozimin e Munirit. Kush është pro propozimit të Munirit? Ju lutem, dëgjoni, e keni pasën kohën e diskutimit, jua kam dhënë fjalën. Këtu e di Rregulloren unë, të lutem, Jetmir! Nuk t'u përmend emri, të lutem, te pika tjetër ta jap fjalën. Pika është: Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Statutit të QKMF-së. Një kërkesë ishte prej z.Munir, që të jetë Neni 13, gjë që Ministria e ka kthye prapë. Ne nuk jemi që të shkojmë kundërligjshëm. Unë thashë, të dy propozimet kemi me i qit. Njërin kemi me e qit qysh e ka kthye Ministria, dhe tjetrin me propozimin e Munirit. E qes në votim propozimin e Munirit. Kush është pro? A ka kundër? A ka abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, nuk kalon.

Munir Jonuzi: Ju lutem përsërisni votimin.

Arijeta Skeraj: Okej, edhe një herë. Kush është pro propozimit të Munirit? A ka kundër? A ka abstenim? Me 6 vota pro, 7 kundër dhe zero abstenim, atëherë nuk kalon kjo. Atëherë, shkojmë me propozimin qysh u kthye nga Ministria.

Munir Jonuzi: Zonja Kryesuese, në bazë të kompetencave kushtetuese që kam unë, ju po vendosni rendin këtu, në bazë të kompetencave kushtetuese që kam, kam vërejtur se të gjithë delegatët nga komuniteti joshumicë kanë qenë pro propozimit tim, ndërsa delegatët e komuniteti shumicë ishin kundër ose abstenoj, i kërkoj Kryesuesesë së Kuvendit të përsërisë votimin.

Arijeta Skeraj: Munir, të lutem, unë jam këtu, nuk ta jap fjalën, ashtu qysh nuk ua kam dhënë as atyre. Të lutem, ulu, përndryshe, e ndërpres seancën!

Arijeta Skeraj: Atëherë, të nderuar asambleistë, e qesim në votim rekomandimin që ka ardhë nga Ministria. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 17 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për pagesën e komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës. A do dikush me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Zonja Kryesuese, këtu këtu i referohem Kushtetutës dhe ju nuk më lejoni të flas këtu. I referohem Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Unë kam kompetencat Kushtetuese t'ju kërkoj të përsërisni votën përpara se të paraqes këtë Vendim për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Nëse kryesuesi nuk më lejon të shfrytëzoj kompetencat e mia kushtetuese, atëherë çfarë i mbetet kompetencave ligjore apo nënligjore?

Arijeta Skeraj: Të lutem, Munir, unë jam kryesuese këtu! Unë e qita propozimin. Kur nuk ua jap atyre të treve fjalën, as ty nuk ta jap. Vazhdojmë me pikën e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për pagesën e komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës. A do dikush me e marrë fjalën?

Driton Ademi: Atëherë, te Vendimi për pagesat e komiteteve të themeluara nga Kuvendi. Ne si Grup Parlamentar i kemi edhe dy pika me i shtue te këto pagesat. E kemi: Të shtohet pagesa e kryetarëve të fshatrave, të cilët na vetë i kemi miratue. Unë e parashoh, përderisa ke pru vendim prej Kuvendit, në këtë vendim mundesh me e shti edhe pagesën e kryetarëve të fshatrave. Po pse duhet me e pru në seancë pagesat e Komitetit, kur e ke me ligj me i pague?! Po nuk është problemi jonë pse nuk është i paguar. Pse s'i ka pague qeverisja komitetet, unë nuk kam faj. Unë po kërkoj që këtu të shtohet pagesa e kryetarëve të fshatrave, edhe e dyta: Pagesa e përvojës së punës të Asamblesë. Te kjo, unë sa e di, shumica e komunave – mundeni me e pa edhe para kamerave, megjithëse ia kam kërkuar dikuj – kjo është mënyra që iu vjen një email, mësuesve, mjekëve e këtyre tjerëve. Neve Asamblesë nuk na paguhet as përvoja e punës, as kurgjo, as nuk na vjen në email. Arsyetimi është, thuhet se Ministria po na kthen prapë për arsye se nuk mundim me i bo

pagesat e përvojës së punës. Kjo është qesharake. Krejt komunitat – kam edhe fotografi të pagesave që iu vijnë në email – krejt komunitat janë pagujnë përvojën e punës, neve nuk na pagujnë. Unë nuk e di çka është problemi, një Komision u formua para disa viteve, ka mbetur ai Komisioni, nuk bën asnjë punë. Këtë problem, kryetar edhe drejtor, është mirë me e zgjidhë, se krejt komunitat e kanë të zgjidhur. Pse si Komunitat ne nuk e kemi të zgjidhur? As nuk na vjen në email, më e keqja që nuk na paguhet përvoja e punës. Unë kërkoj që të futen këto dy propozime. Faleminderit!

Uran Halimi: Tash, po më vjen shumë keq që shpeshherë po na katandiset ky Kuvend. Aspak demokratike mënyra se si po funksionojmë, duke na mohuar të drejtën e fjalës. Po duhet me e prit një pikë tjetër të rendit të ditës për me diskutue për pikën paraprake. Kjo nuk po më pëlqen mu.

Arijeta Skeraj: Të lutem Uran, as mu nuk po më pëlqen, po me Rregullore e kam. Një herë ke të drejtë, edhe një herë për replikë. Të lutem, nuk po ta mohon të drejtën e fjalës kërkush, ja ti je duke folë, ja kërkush.

Uran Halimi: Faleminderit, znj.Kryesuesë! Këtu jemi ne për me folë, kemi ardhë këtu edhe na ka prurë qytetari për me folë, edhe ty edhe mu. Përgjegjësinë e ke pak më të madhe, sa i përket ndarjes së kohës edhe dhënies së fjalës. Duhet me na trajtue njëjtë, mos u mundo me plotësue qefe këtu, të kujtdo, edhe me marrë dreksione se kujt duhet me ia dhënë fjalën. Ne kemi të drejtë me e lyp fjalën, bën vaki edhe dy herë. Është një Rregullore që edhe po e tejkalojmë, ne po i kontribuojmë të mirës së qytetarëve këtu. Nuk bëhet nomi nëse e ka marrë fjalën dy herë, ose tri, edhe folën diçka të vyeshme edhe i kontribuon qatyre gabimeve që mos me u përsërit. Sidoqoftë, tha edhe z.Ademi që janë të rregullume me ligj. Sa i përket Komisionit që u ndërlikue, ne kemi pas veç me i hetue ato, ne nuk bëjmë vendime, i nderum, na nuk mundim me bo vendime a paguhet dikush, a s’paguhet. Na veç kemi pas me i hulumtue lëshimet e mundshme për të cilat na keni akuzue vazhdimisht. Thashë edhe dje në Komitet, se më pyetën prapë, Komisioni ekziston, ka mandat deri në fund të qeverisjes. Ne mundim me funksionue dhe funksionojmë nëse ju e shihni ndonjë lëshim ose parregullsi në pagesa. Do ta vazhdojmë punën deri në fund të mandatit, se ka punë edhe jam duke e parë që vazhdimisht është duke na u shtuar puna. Kemi me dalë me një konkluzion diku në fund të mandatit. Mos u mundohnu me u lidhë te ai Komisioni, se na s’mundim me marrë vendime a paguhet kryetar të fshatrave apo jo. KKSB-ja me ligj është e rregullume me u pague. Këtu është qëllimi – unë e di ku është qëllimi – është te pagesa e Komisionit për Siguri në Bashkësi. Ajo është e rregullume me ligj, qysh e di unë. Tash, nëse doni me ia rrit atë pagesë, ose me i dyfishue, ne

s'kemi të drejtë me e marrë atë vendim. Por janë ligjet, janë ministrinë përkatëse të cilat mundeni me u informue edhe me kqyrë çka po mundim me bo në lidhje me këtë. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Nuk po due me bo debat, kryesuese, edhe me e nxehtë situatën, po ma more të drejtën e fjalës parëz, nuk ma dhaje fjalën. Dikujt ia dhaje dy-tri herë, unë e ngrita dorën edhe nuk ma dhaje fjalën, po s'është problem, herave tjera, masi jam në qyshe qatje, kqyr edhe një herë kah unë. Me ty, si kryetar i atij Komisionit, edhe dje të kam pyet, është mirë me i vazhdue deri në fund të mandatit. Por Driton Ademi, në qoftë se ka dëshmi, edhe bjer dëshmi që në komunat tjera po paguhet përvoja e punës, atëherë kur të mblidheni ju si Komision, ta verifikoni edhe këtë çështje. Po ju lutem kryesueses edhe Komisionit, se Komisioni është i formuar nga ky Kuvend. Në qoftë se i ka këto dëshmi Dritoni prej komunave tjera, është mirë me i marrë, me pru si material shtesë, me ia pru kryesueses, ajo me ia dhënë Komisionit edhe ju me e bo verifikimin. Është mirë ju Komision me e kqyrë edhe këtë problem.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! E para të kërkoj falje, ndoshta s'e kam pa prej atmosferës që u krijua në sallë. E dyta, edhe unë i bashkëngjitem, është mirë që të diskutojmë për këshilltarët e fshatrave me një pikë të veçantë të rendit të ditës. Dhe, pse jo, masi krejt komunat po i paguajnë, pse edhe ne mos me e marrë vendimin. Kështu që, jam e hapur, unë në seancën tjetër munda me e qit pikë të veçantë edhe me e diskutue, ajo nuk ka diskutim. Sa për përvojën e punës, Driton, duhet me shkue te menaxheri i Personelit edhe me u konsultue me të, për me e bo përvojën e punës së asambleistit. E dyta, këto janë komitetet obligative, KPF-ja dhe Komiteti për Komunitete, dhe KKSB-ja. Por, siç e dini, në Komitete nuk kemi telashe, por KKSB-ja nuk është pague. Veç për këtë punë ka ardhë kjo në rishqyrtim.

Uran Halimi: Unë deshta vetëm ta sqaroj. Komisioni për të cilin po diskutojmë është i formuar vetëm me hetue për ndonjë lëshim të pagave. Nëse ka lëshime për pagesave, për shembull të neve në këtë rast, qato mundim na me e bo. Po ai Komision nuk munden me marrë vendim. Nëse ju mendoni që na duhet me e bo një sugjerim, qoftë edhe në Ministri përkatëse, mundim na me e bo. Mirëpo, vendim na nuk mundim me marrë. Komisioni, unë jam i hapur edhe si Komision edhe si Kuvend, na mundim me diskutue, me bo propozime, unë hiç s'e kam problem, meqenëse jam kryetar i atij Komisioni, nuk e kam atë obligim po thjesht e bëj. Nëse ju e shihni diçka të arsyeshme, me bo një rekomandim, një përmbledhje, unë jam i hapur edhe bashkëpunoj kurdo që ju mendoni. E mbajmë një takim, qoftë edhe mas seancave të Kuvendit, qoftë edhe një ditë ekstra. Mirëpo, nuk mundemi unë si kryetar dhe as anëtarët e Komisionit me marrë vendime në këtë rast. Propozimet

që ju doni me i bo na mundim edhe me e mbajt një takim, edhe ma tepër se anëtarë të Komisionit, mundim si Kuvend mbajt takim, edhe me e marrë një propozim ose një përfundim që me e bo një kërkesë, qoftë Zyrës së Personelit, qoftë ministrive përkatëse, edhe me e marrë një vendim të favorshëm ju qysh po thoni. Mirëpo, ne nuk mundim me marrë vendime në këtë rast. Jam i gatshëm për me punue me Komisionin, me anëtarët e Kuvendit, me secilin, pa problem hiç. Mirëpo, nuk jam unë fajtor pse s'po paguhet KKSBB-ja në këtë rast, ose këshillat e fshatrave. Nëse ne mendojmë që duhet me u pague këshillat e fshatrave, e marrim me një vendim të Kuvendit, por jo të Komisionit. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Siç e cekti edhe Urani, Komisioni ishte për ato ndalesat që na u kanë bo disa herë në paga, edhe u formuar ai Komisioni prej Kuvendit. Z.Driton e përmendi, por e kisha lut që na këtë me e qit në Kuvend si pikë të rendit të ditës edhe me i mbështet ata. Sot nuk është për këtë.

Driton Ademi: Kryesuese, më së pari shpresoj që të mos i hashë fjalët. Presim që në seancë e ardhshme ta qesish në pikë të rendit të ditës, si pagesat e kryetarëve të fshatrave. Por, Komisionit unë nuk i thashë për me marrë vendim, se e keqkuptoi, por është mirë me e shqyrtue. Megjithëse unë po them shumë hapur, disa muaj mu më janë paguar. Para tre-katër muajve kam ndie që disa tjerëve u janë pague. Nuk munden dikujt, Dritonit me ia pague, e mos me ia pague Shpetimit. Kjo është e palogjikshme, vendimi është për të gjithë. Për të gjitha asamblëtë komunale, si për Dragashit, si për çdo qytet tjetër. Unë nuk e di pse vjen deri te këto konflikte. Nuk është puna në pare, është puna pse nuk po e zbatojnë një Rregullore që është në të gjithë Kosovën. Edhe nëse ti po thuesh që jeni të pajtimit me i qit qeto dy pika në seancën e ardhshme, atëherë unë tërhiqem. Për përvojën, unë nuk i thashë kryetarit me e marrë vendim. Unë kam me u mundue me jau pru të disa qyteteve, që si Komision me e pa që e kanë këtë rregullime me ligj. Pse te na nuk zbatohet?! Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Mirë që ra kjo pikë dhe po dalim tash po diskutojmë edhe për do pika tjera të rëndësishme. Tash, ndoshta edhe ka prej atyre që thojnë vetëm për rrogat e juaja po diskutoni. Por, ato na takojnë ligjërisht edhe natyrisht që i meritojmë t'i marrim. Në fjalimin e Dritonit, natyrisht, ne i dhamë të drejtë si Grup, që të dalë dhe ta bëjë një kërkesë të tillë. Unë e mbështes, natyrisht, atë që e tha Dritoni, por sa i përket çështjes së asambleistëve, që neve s'po na paguhet përvoja e punës, nuk e di pse na me e kërkue këtu dhe me e marrë një vendim, kur ligjërisht neve na takojnë. Kjo i takon zyrtarit kryesor kush është që merret me Personelin, ai duhet ta rregullojë këtë çështje.

Na i ka humbur dy-tri vite e sa, nëse na kompenzohen mirë, nëse jo, së paku të fillojë prej janarit dhe të na jepet ajo që e meritojmë. Gjithashtu, tek ky Vendim i cili sot na ka ardhë nga ekzekutivi dhe për të cilin ne po diskutojmë – e tha më herët edhe një koleg asambleist, që edhe kjo çështje është e rregullume me ligj. Nuk e di tash kush janë njerëzit kompetentë, përgjegjës për këtë punë, që nuk e kryejnë punën si duhet, dhe na vjen tash neve ta votojmë këtu prapë këtë çështje. Kuptova që problemi është tek KKSJ-ja, se këta nuk paguhën. E di që këta janë paguar më herët, por paska vite të tëra që s’po u paguakan. Ligjërisht këta duhet ta marrin pagesën. Pse i kanë lënë në pritje deri më tani, e dinë ata njerëz të cilët janë përgjegjës për këtë çështje. Natyrisht ne do ta mbështesim, që të mos i lëmë në pritje këta njerëz të cilët punojnë për sigurinë dhe të mirën e qytetarëve. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pika. Atëherë, fillojmë te pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit. Atëherë, kërkoj fillimisht një emër për Komision prej Grupit të PDK-së.

Shpetim Hajredini: Në emër të Grupit të PDK-së, për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit, e propozojmë profin Nexhat Selaj.

Arijeta Skeraj: Atëherë, lista që më është dërguar nga LDK-ja, është z.Samidin Xheladini. Prej VAKAT-it më ka ardhë z.Munir Jonuzi, prej ekzekutivit Dren Myrtezani dhe Usamedin Haruni.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Faleminderit për propozimin, unë u lejoj hapësirë të tjerëve. Le ta propozojnë një kandidat tjetër. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! E kisha lut shefin e Grupit të LDK-së që ta japë një emër tjetër në vend të z.Samidin Xheladini.

Mehmet Spahiu: Përshëndetje për të gjithë! Në emër të LDK-së ne propozojmë Gazmend Ramadanin për anëtar të Komisionit.

Artan Loshaj: Unë e kam një pyetje. Këtë Komisionin që po e formojmë, sa do të ketë mandate? Edhe, ky Komision a do të funksionojë edhe si Komision për Listën Rezervë. E kam pyet edhe dje kryetarin, se ju si LDK na keni akuzue neve ma herët që nuk kemi pas komision për listat rezervë. Ju kam pyet edhe dje në Komitet, a do të emërtoni edhe emra të gjinisë së kundërt, gjinisë femërore, për arsye se duhet me e fitue edhe Grantin e Performancës, edhe zyrtarja për Barazi Gjimore ka pas disa ankesa. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ky Komision ka me qenë deri në fund të këtij legjislativi. Atëherë, kush është pro kësaj pike? A ka kundër? A ka abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenime, e miratojmë edhe këtë Komision. Atëherë vazhdojmë me pikën e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit.

Driton Ademi: Atëherë, ne si Grup Parlamentar i PDK-së, propozojmë Shpetim Hajredinin.

Arijeta Skeraj: Atëherë, nga radhët e LDK-së është Anesa Mehmeti, nga JGP është Edin Kurt, dhe nga Komuna janë Fari Kolloni dhe Islam Redzeplar. Kush është për këtë Komision? A ka kundër? A ka abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenime, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ZK Dragash P-70604014-00099-1 me pronën e përbashkët të z.Amir (Ahmet) Jamini, z.Asad (Ahmet) Jamini, Rehjan (Omer) Jamini dhe Nerkes (Omer) Jamini, prona me numër të parcelës P-70604014-00827- 2 ZK Dragash. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj?

Driton Ademi: Kryesuese, pasi është koha edhe e drekës edhe jemi afër dy pikave të fundit, unë po propozoj që të marrim pauzë, se edhe është fundi i vitit, te pika eventuale askush nuk po na rri qe disa seanca. Është mirë me marrë ma herët pauzë, kthehemi më herët dhe me qenë të gjithë te pika eventuale. Siç e dish, edhe në seancat e tjera pika eventuale nuk kemi pas kuorum. Unë po mendoj që këto dy pika le të rrinë, se ashtu kështu duhet me i votue në Kuvend, masi të kthehemi prej pauzës. Propozim prej Grupit Parlamentar. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Unë pasi veç e kam qit këtë pikë, këtë do ta bëjmë, se edhe 15 minuta, në ora 12:00 dalim në pauzë, deri në ora 13:00. Atëherë, a do dikush me e diskutue këtë pikë?

Shpetim Hajredini: Kishte qenë mirë, atëherë, kryetari ose kushdo prej ekzekutivit që ka informacione më të detajuara për këtë çështje që tani do ta diskutojmë, me dalë me na dhënë informacionet më të sakta dhe pastaj po vendosim për votimin. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, edhe pse në materialin e Propozim-vendimit që ju është dorëzuar, detajisht shkruan qëllimi i këmbimit të pronës, siç e dini, ne si Kuvend Komunal para dy muajve kemi planifikuar që ta bëjmë kubëzimin e asaj rruge e cila shkon prej Bibliotekës, mirëpo kemi hasur në rezistencë të pronarëve, të cilët janë të cekur në këtë Propozim-vendim. Dhe, ne kur kemi shkuar në Kadastër, e kemi vërejtur se ajo de facto ekziston si rrugë, por është pronë private. Nuk janë kryer më herët ato procedurat ligjore për këmbimin e pronës, kështu që ne me

ligj nuk kemi të drejtë me shtrive rrugë në pronën private. Andaj, kemi bo një bisedë me këta pronarët – kanë qenë at ate unë në zyrë – edhe ata janë pajtuar që ta bëjnë këmbimin e pronës, një me një, dhe nuk kanë kërkuar ndonjë vend të përshtatshëm, por kanë thënë se, ku ka pronë komunale, nëse na i merrni tre ari, me na i dhënë tre ari. Ky ka qenë qëllimi, kështu që, nëse e bëjmë ne këtë, atëherë ne mund ta shtrojmë atë rrugë me kubëza, ashtu siç e kemi paraparë me projekt. Faleminderit!

Artan Loshaj: z.Kryetar, pasi unë jetoj edhe në Dragash, disa çështje i di pak më mirë se disa delegatë. Është mirë me bo zgjidhje, por për fat të keq, e dish ku e ke problemin, pak ma nalt, jo te ky vendi. Te ky vendi ka vend për kubëzim edhe është rrugë ekzistuese. Kur thatë se na nuk kemi të drejtë me bo kubëzim në pronën private, në krejt Komunën e Dragashit u bo kubëzim në prona private. Po biesh ndesh me vetveten. Në çdo parcelë, në çdo fshat, në çdo lagje je t’o bo kubëzim në prona private. Unë kam qef me u zgjidh ky problem, po ky problem është pak më i madh. Në këtë pjesë ku ju po doni me e shpronësue, unë sa e di, duhet me qit në ankand publik shpronësimin edhe me konkurue. A ju qysh po doni me bo, këtu ka vend, është mirë edhe atij me ia mundësue, se s’ka me çka maron aty nalt në atë pjesën, është mirë me ia dhënë atij. Por në qoftë se fillosh me e bo zgjidhjen e këtij problemi, të kësaj rrugës, ti e dish shumë mirë që e ke qit në tender edhe të është ndërprerë. Edhe me e bon a këtë, unë jam për, po edhe me e bo ti këtë, ti qat rrugë nuk ke me mund me e shtrive, se është në proces gjyqësor. E dini shumë mirë. Kur të filloni prej Bibliotekës deri në udhëkryqin Radeshë-Libevishtë e bëjmë krejt. Zgjidhne një herë qat problemin, është mirë me u zgjidhë, edhe masnej me e qit ndërrimin e kësaj parcelës. Thashë shumë mirë – s’di a më kuptove – edhe me e bo qat rrugë, s’kemi me mund me e kubëzue, se është në proces gjyqësor. Edhe prona private jeni t’u shtrive, e t’u shtrive, mos t’ia nisim se nuk është tema.

Bexhet Xheladini: Në pjesën e rrugës e cila është në contest gjyqësor, nuk e prekim se atë nuk kemi të drejtë. Kjo pjesë nuk është në contest gjyqësor. Palët po pajtohen, janë pajtuar, edhe pse është pronë private, po pajtohen me shkëmbye pronën një me një. Edhe nuk po zgjedhin vend, nuk po thojnë me ma dhënë në Dragash, kanë thënë te stadioni, ku të ka vend pronë komunale, për hir të interesit të përgjithshëm, nuk dona me përfitue, vetëm dona me tregue që Komuna pse jemi komunitet joshumicë mos me na shkelë. Është me pajtimin e tyre edhe rruga do të fillojë me u kubëzue Policia e naltë, deri në vendin ku nuk ka contest gjyqësor. Unë shpresoj që vitin e ardhshëm me rrugën që e kemi nis dhe e kemi ndërprerë contesti gjyqësor do të zgjidhet, dhe pastaj

do ta vazhdojmë deri te udhëkryqi. Por unë besoj që deri në fund të mandatit këtë problem do ta kryejmë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Me 14 vota pro, 1 kundër dhe 3 abstenime, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, të nderuar asambleistë, tash koha e pauzës, në ora 13:00 kthehemi në sallë. Faleminderit!

Atëherë, përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Po fillojmë me pjesën e dytë mas pauzës. Po vazhdojmë me pikën e tetë: Raportim për performancën e Komunës. Kush do me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm, siç e dini, ne si Komunë për herë të tretë jemi fituese e Grantit të Performancës. Ndërsa, nga viti i kaluara, MAPL-ja, në bashkëpunim me donatorët, një prej kritereve të vlerësimit e ka qit edhe a është diskutue Granti i Performancës në Asamblenë Komunale. Ne vitin e kaluar e kemi diskutuar, mirëpo gabimi ynë ka qenë që, kur e kemi plotësue atë formularin, ne e kemi çue vetëm vendimin edhe rendin e ditës që është mbajt, ndërsa ishte dashtë me e çue edhe procesverbalin e diskutimeve që janë bo. Kështu që, për këtë qëllim ne planifikojmë që të konkurrojmë edhe më tutjë për Grantin e Performancës për vitin e ardhshëm. Kjo është Asambleja e fundit për këtë vit, kështu që është momenti i fundit që sot ne të debatojmë për këtë çështje dhe të marrim pikë për këtë. U bo shumë debat rreth atij votimit për Statutin e QKMF-së. Unë edhe në fillim thashë që ne të gjithë këtu e kemi shpreh vullnetin e mirë dhe e kemi votue të gjithë që ajo pikë të ekzistojë. Megjithëse e kemi ditë që ajo nuk është ligjore dhe nuk është në harmoni me Statutin Unik të QKMF-ve në nivel të Kosovës. Edhe thashë që është kriter që rekomandimet që vijnë nga MAPL-ja, ne ato duhet patjetër që t'i votojmë ashtu siç kanë kërkuar ata, edhe i përmenda arsyet pse. Nëse, për shembull, vjen për herë të parë dhe e kthejmë, dhe e kthejmë prapë për herë të dytë, atëherë lënda shkon në gjykatë dhe shkojnë në gjyq kryesuesja dhe kryetari. Gjithashtu, siç thashë edhe në fillim, për me e fitue Grantin e Performancës, së pari duhet me i plotësue katër kritere kryesore. Nëse kualifikohesh me këto katër kritere, atëherë hysh në poenizim dhe, varësisht prej numrit të banorëve edhe pikëve, atëherë i marrish edhe paratë në vlerë sa të takon. Këto katër kriteret kryesore apo kushtet minimale janë: 1) Komuna duhet ketë raportuar të dhënat në SPMPK sipas afateve të përcaktuara me ligj; 2) Komuna duhet të ketë respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuar si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës – kjo është ajo që e thashë, nëse ne e kishim refuzue këtë pikë, ne nuk kishim pas të drejtë që vitin e ardhshëm me konkurruar për Grantin e Performancës, se këto janë katër kushtet

kryesore për me hy në garë, njëlloj sikurse kualifikimet në Botëror qysh janë për futboll. Kështu që, në krahasim me vitin e kaluar, ne këtë vit thuajse i kemi dyfishuar pikët, kemi një ngritje të performancës komunale sa i përket ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Vitin e kaluar i kemi pas diku 28 pikë, ndërsa këtë vit i kemi 54 pikë. Pikët maksimale që është dashtë me i arrit janë 90. Ka disa pika që nuk mundemi me i arrit, sidomos te barazia gjinore; punësimi duhet të jetë mbi 50%, pastaj mbi 50% duhet të jetë gratë në pozitat udhëheqëse. Gjithashtu, edhe te tatimi në pronë, për me marrë një poen duhet ta kalojmë mbi 35% të mbledhjes së tatimit në pronë. Kështu që, na mbetet punë për vitin e ardhshëm, që këto pikë të cilat i kemi këtë vit t'i rritim ato. Unë besoj që do të kemi rritje, por assesi ne nuk mund ta arrijmë maksimumin, sepse thuajse asnjë komunë atë nuk e arrin. Vlera e Grantit të Performancës ende nuk na ka ardhë zyrtarisht, mirëpo dje e kemi pas një takim me DEMOS-in dhe dy donatorët kryesorë të GP-së. Shuma do të jetë më e lartë se vitin e kaluar. Vitin e kaluar i kemi pas diku 360 mijë euro, këtë vit do ta kemi sigurisht mbi 400 mijë euro. Nëse ka dikush ndonjë pyetje, mund t'ju përgjigjem pastaj, Për fillim kaq. Faleminderit!

Edin Kurt: Pershendetje te gjithëve. Duke qenë se jame 3 vite këshilltar i këtij kuvendi dhe jemi në koalicion me ju, ju kemi mbështetur gjithmonë. Tani kur erdhi koha që ne të kërkojmë diçka, ju nuk na mbështetët. Dhe kjo duhet të jetë nën ndërgjegjen e juaj, duke qenë se e pamë se si jeni sjellë ndaj zëvëndes së Kryesuesës së Kuvendit, i cili është njeriu i dytë në këtë kuvend, si do të silleni me të tjerët? Dhe kjo duhet të jetë në ndërgjegjen juaj.

Arijeta Skeraj: Artan, të lutem, qe 20 herë je t'u më thonë e lëshoj seancën. Kërkush nuk të mban me zor këtu. Mundesh me e lëshue, si të tjerët qysh e kanë lëshue, unë këtu vendosi. Edhe Uzairi ka të drejtë me dalë me folë për performancën.

Nedžmidin Sejdlar: U ula në vendin tim vetëm për të pritur reagimin e Kurtit dhe të JGP-së. Ajo që bëtë sot në këtë kuvend është e tmerrshme. Ju nuk e keni lejuar njeriun që është i obliguar me ligj të mbrojtë të drejtat e komuniteteve joshumicë të flasë dhe të paraqesë propozimin e tij. Veç kësaj, sjellja e kryetarit të komunës që më ka ndjekur në korridor dhe në komunikimin që kam pasur me Edinin, duke më quajtur qen, zoti Hamza është dëshmitar se e gjithë kjo ka qenë kështu, nuk e di nëse ai ka guximin t'i thotë të gjitha këto, ky kuvend ka humbur kuptimin dhe ju keni dëshmuar se po ndiqni një politikë kundër komunitetit të shumicës. Jam dakord me zotin Kurt dhe nuk shoh asnjë arsye pse të ulem në atë karige dhe të miratoj gjërat që ju bëni. Z. Jonuzi ka pasur të drejtë të propozojë, ka autoritetin ligjor të flasë kur të dojë, vetëm për ta ndezur atë mikrofon sepse është edhe vizualisht në atë vend ku është. Përndryshe, pse do të rrinte këtu? Ju treguat ftyren

tuaja të vërteta sot, se po udhëheqni një politikë anti-gorane dhe kjo le të mbetet në ndërgjegjën tuaj. Sa i përket performancës, ne nga komuniteti goran nuk shohim ndonjë përfitim në këtë. Dhe grantin e fundit që e ke marrë, ne në Gorë nuk kemi parë asnjë përfitim. As nuk do ta mbështesim. Dhe kjo performancë është dëshmi se ju po ndiqni një politikë antigorane. Këtë do t'ju lë juve në ndërgjegjën tuaj, do të largoheni nga ky kuvend dhe do t'u bëj thirrje këshilltarëve të tjerë të komunitetit goran që të solidarizohen dhe të dëshmojnë një herë të vetme unitet, t'ju qëndrojnë në rrugën tuaj, të ndaloni së ndjekuri politikën antigorane.

Arijeta Skeraj: z.Sejdilar, të lutem, nëse ke diçka vetëm për rendin e ditës, përndryshe ta ndali fjalën. Ti neve mos na trego qysh me udhëheq mbledhjen, të lutem, vetëm për performancën. Mos shti këtu, qysh ia ke zanat gjithmonë.

Driton të kërkoj falje, fillimisht do ta marr unë fjalën!

Atëherë, edhe pse s'pata me e marrë fjalën, por më detyruan shumë njerëz. Siç e dini, Grantin e Performancës e bën edhe Kuvendi Komunal. Pasi u ngritën të gjithë këto akuza, deshta të ju sqaroj se qeverisja demokratike, roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës, pjesëmarrja e konsultimit dhe gjithëpërfshirjes së qytetarëve, transparenca, qasja në informata dhe integriteti, gjithsej janë 27 pikë. Kuvendi i Komunës së Dragashit për një vit i ka mbërri pikët maksimale 27. Sa për te Edin Kurti, zv/kryesuesi gjithmonë ka qenë i privilegjuar. Jo nga ana e kryetarit – nuk e flas atë pjesë, por nga ana ime. Arsyeja pse ai doli i tendosur prej këtu, unë nuk mund të ia mbështes diçka që më vjen antiligjore prej Ministrisë. Dhe unë këtu, bashkë me të gjithë ju, jemi organi më i lartë legjislativ, në qoftë se ne do ta shkelim ligjin, atëherë çka do të bëjnë zyrtarët e tjerë. Unë nuk jam kundër komunitetit. Sa për Sejdilarin, u mësue ai kështu, absolut nuk janë të shkelur. Të gjithë qytetarët e Dragashit e dinë se buxheti ndahet edhe për goranët, edhe për shqiptarët. Nuk kam as emocion që ai u hidhërua edhe që ka dalë. Nuk mundem unë me e ndryshue Nenin e Munir Jonuzit, për tekat e veta, ajo është e jashtëligjshme. Jo vetëm e Munirit, por e asnjë asambleistit nuk do të përkrahet nga ana ime nëse nuk është e ligjshme. Unë nuk jam mësuar kështu, unë vetëm ligjërisht mundem me punue, mundeni me e kqyrë punën e Kuvendit, janë 27 maksimalja kanë ardhë prej performancës. Kështu që, unë jam shumë e kënaqur me punën, andaj e falënderoj të gjithë Asamblenë, e falënderoj Zyrën e Kuvendit që po e bëjnë një punë të mrekullueshme. Pasi më nuk do ta marr fjalën, unë deshta të ju uroj edhe këtë vit që e kemi kaluar shumë mirë. Ndonjëherë kemi pas edhe ndonjë telashe të vogël. Dua të ju uroj Vitin e Ri 2025! Shpresoj që viti 2025 ka me qenë më i begatshëm, me shëndet dhe sukses!

Driton Ademi: Atëherë, unë i kam dy pyetje për kryetarin. Te Qeverisja Demokratike – diskutim për Raportin e performancës komunale – kryetar, pse nuk ka pikë të qekjo. Edhe te Diskutimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm dhe Planit të Veprimit. Po më vjen se këto i kemi bo, po më intereson pse nuk ka pikë të këto? Edhe Pjesëmarrja e Qytetarëve në Konsultime Publike Sipas Gjinisë? Këto tri pika. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Unë përgjigjen për 3-shin e dhashë edhe në fillim të diskutimit. Arsyeja pse e kemi pru me e diskutue sot, në Asamblenë e fundit, është se tash ka hy edhe kjo pikë në vlerësim me poena. Ne vitin e kaluar e kemi diskutuar Raportin e Performancës në këtë Asamble, por kur e kemi bo plotësimin e pyetjeve dhe përgjigjeve, e kemi ngarkuar vetëm me rendin e ditës. Mirëpo, është dashtë me e çue dhe procesverbalin, për atë ne kemi marrë zero pikë. Ju siç e dini, edhe diskutimin e Raportit të Auditorit të Jashtëm e kemi bo në Asamble, mirëpo këtu është një gabim, kemi mundur të ankohe mi, mirëpo edhe vitin e kaluar jemi ankuar por nuk na kanë pranuar ankesën. Kështu që, në mbledhjen që e kemi mbajt me anëtarët e Grupit të Performancës, kemi marrë vendim që mos me u ankue. Te Pjesëmarrja e Qytetarëve në Konsultime Publike i Disreguar sipas Gjinisë, nuk kemi mujt me e mbërri atë kuotën e gjinisë. Duhet me e mbërri një përqindjë të popullatës e cila ka marrë pjesë në diskutime publike, në bazë të përqindjes së popullsisë. Atë ne nuk mujm me e arrit as vitin e ardhshëm. Me mijëra veta duhet me marrë pjesë në debate, për me e mbërri e me marrë pikë në këtë. Për atë të thashë, janë disa pika të cilat s’ mujm me i arrit e të cilat ata i kanë vlerësue me shumë poena.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro këtij Raporti të Performancës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 15 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e fundit, pikën eventuale.

Nexhat Selaj: Faleminderit, kryesuese! Përsëndetje kryetar, kolegë asambleistë dhe ju media! Para se të kisha filluar diskutimin tim i cili zakonisht do të ketë qasje rreth arsimit, një e pazakontë – kryetar – që këto kohët e fundit simbole shtetërore, pikërisht kur bëhet fjalë për flamuj para objektit komunal, po mungojnë. E kuptoj se është nga neglizhenca ose nga ndonjë punë e cila ka filluar dhe nuk është kryer, por realisht një pasqyrë jo e mirë po del, që të hymë para një objekti shtetëror e mos të kemi simbolet, që bëhet fjalë pikërisht për flamuj. Besoj se do ta eliminoni së shpejti këtë. Ishte ndoshta pak edhe për keqardhje, e festojmë Ditën e Flamurit më 28 Nëntor, e ne flamujt nuk i kishim të vendosur para objektit. E kuptoj se është neglizhencë, por kishte me qenë mirë që të punohen këto. Sa i përket fushës së arsimit të cilës edhe i përkasim, edhe gjithmonë

tentoj që të përmirësohen të gjitha ato lëshimet eventuale të cilat bëhen – po më duken se skandalet në Arsimit nuk po kanë të ndalur. Këtu e paskam drejtorin e Arsimit, edhe të gjitha këto pika të cilat do t'i parashtroj, kam qef t'i dëgjoj nga drejtori. Pavarësisht skandaleve – drejtor – me mossjelljen e dy mjekëve në Shkollën e Mesme të Lartë “Ruzhdi Berisha” për muaj të tërë, tash krejt së fundi i keni sjellë. Faleminderit! Më mirë vonë sesa hiç. Por, deshta të të pyes: Në bazë të cilit Udhëzim Administrativ të vlerësimit do të vlerësohen këta nxënës, kur në bazë të Rregullores për Vlerësimin e Nxënësve, nxënësi duhet t'i dëgjojë të paktën 2/3-tat e procesit mësimor. Nëse e shikojmë se kur janë sjellë mjekët për të vazhduar procesi mësimor, i bjer se rreth 80% të orëve mësimore nuk janë mbajtur. 20% janë orë të cilat mjekët kanë ardhë, që i bjer rreth 8 orë të mbajtura, dhe ne vetë si msëimdhënës dimë se ora e parë është orë e prezantimit, ora e dytë e prezantimit të Planit dhe Programit Mësimor. Për gjashtë orë, sa do të ketë arritshmëri që nxënësi të mësojë dhe kur do të ketë kohë që mësuesi t'i vlerësojë ata? Unë e vë në pikëpyetje se këta nxënës mund të rrezikohen edhe nga notimi, kështu që mund të humb edhe viti shkollor, nëse përcillet Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve në mënyrë të rregullt. Dy: Një skandal i cili po zgjat këto tri vitet e fundit, është furnizimi me dru. Qoftë në vitin e parë, qoftë në vitin e dytë, po edhe në vitin e tretë, gjithmonë kryetarit i kam parashtuar pyetje, gjithmonë ka qenë përgjigjja se ofertuesit po kanë neglizhencë në kryerjen e punëve. Unë gjithashtu, kryetar edhe drejtor, kam folë nga ato të cilat i lexoj dhe ato të cilat keni premtuar. Nëse të kujtohet, kryetar, ke premtue se tenderi për dru nuk do të sillet në shtator, por do të sillet në muajt e parë të vitit, dhe në korrik drutë do të përfundojnë. Nëse nuk është ashtu, kam qef me më thënë s'kam thënë ashtu, edhe nëse është ashtu si po ju drejtohem, a keni arsye pse po bëhet furnizimi kaq vonë. Më 20 nëntor të këtij viti kanë fillue të vijnë dru dhe të shpërndahen nëpër shkolla. Nuk po flas për kualitetin, nëse jem realë dhe të flasim, është prej atij kualiteti më të dobët që këto 24 vite pas luftës që janë sjellë deri më tani. Ato vetëm emrin kanë mund ta kenë pas dru, a sipas tenderit kanë qenë dru të ahut dhe të bungut, perimetri nuk është sjellë por viteve të mëparshme ka qenë rreth 15cm. Tash këtë vit, përpos sasisë që nuk ka qenë e duhur e furnizuar nëpër shkolla, kualiteti ka qenë më i dobëti i mundur me të cilin janë furnizue shkollat. Edhe e pyes drejtorin këtu, a nga puna e juaj shumë efikase sot erdhën, sot u sharruan drutë edhe u hupën gjurmët, apo nga ajo marria që t'jau hiqni flomën sa më shpejt, mos të duken e të shohin qytetarët se çfarë është sjellë nëpër shkolla. Mu po më duket se kjo e dyta. Ato gjithçka kanë mund të kenë qenë, vetëm dru djegëse jo. Më 20 nëntor kanë fillue të furnizohen shkollat me dru, a sipas tenderit të cilin e shoh aty, hapja e tenderit duhet të bëhet më 12 dhjetor të

vitit 2024. Hapja po bëhet më 12 dhjetor, a drutë po sillen 1 muaj ditë përpara. Çfarë rregullore këtu parasheh? Mundesh me na dhënë sqarime, je i thirrur për këtë. E treta: Për çfarëdo krenari jeni, kryetar, që keni filluar të ndani, të vazhdoni me këto bursat e studentëve. E keni gjet të tillë nga partia në pushtet e cila ishte Partia Demokratika, tash po vazhdoni. Por, një e keqe këtu po më duket shumë. Me çfarë të drejte ne i largojmë nga bursat ata studentë të cilët kalojnë mbi notën 9 mesataren. Nëse i kemi ne ndihma, edhe te ndihmat duhet të jepen paralelisht për të gjithë njëloj. Por, nëse bursat e kanë atë sinjalin stimulues, që t'i avancojmë ne në dije, në të nxënurit studentët, atëherë nuk duhet t'i anashkalojmë studentët të cilët vijnë me notën mbi 9. Përkundrazi, unë jam i mendimit të të gjithë studentët të cilët mbi notën 9, duhet të kenë dyfishin e atyre të cilët marrin, pasi që nota 9 tregon një dije të lartë. Pikërisht kur bëhet fjalë për mjekësinë, nuk dua të hyj shumë në konkurrencë me drejtimet tjera, por vetë je mjekë, drejtor, edhe ne kemi studentë që nga mjekësia na është largue nga bursa komunale, përderisa aim err bursë universitare. Është në gjendje shteti me dhënë bursë për studentët mbi notën 9, a ne i anashkalojmë studentët tonë. E kur vjen në pyetje të lavdërohem për ata studentë të cilët regjistrohen në mjekësi, ne vrapojmë të parët, nxënës të tonë, nxënës të tonë. Por ata nxënës ne duhet t'i çmojmë. Në grupin e këtyre bursave, te të cilët e shoh të padrejtën, është e pamundur nxënësi i mjekësisë dhe inxhinierisë, të cilët ne i dimë, që të arrijnë mbi notën 9. Klasifikimet nëse dojmë t'i bëjmë, t'i dallojmë pak edhe drejtimet, ose të shkojmë për të gjithë njëloj, ose mos të largojmë asnjë nga ta. Edhe në takimin që shkoi bëra pyetje, a do të vazhdojë edhe sivjet, ne po luftojmë për ata nxënës të cilët po kalojnë dije të mrekullueshme, po zënë nota të larta, po japim bursa, për mbi 500 nxënës po paguajmë transport për nxënës, një e pazakontë po na ndodh, kryetar. Për pesë nxënës me nevoja të veçanta, vitin kalendarik 2023/2024 i keni anashkaluar dhe ata po kanë dro që në vitin kalendarik 2025, edhe këtë vit do të anashkalojnë. Mu po më duket se është pak e tepërt që të foli, prej atyre emocioneve të gjendjes të cilët i kanë prindërit nëpër shpia, veç me të vërtetë e gjynahshme. Me të vërtetë e turpshme, të mos nxjerrim buxhet për pesë nxënës të cilët udhëtojnë jashtë lokacionit të Dragashit, po mendoj jashtë regjionit tonë, por në regjion të Prizrenit apo të Pejës, të paktën bare shpenzimet. Ata kanë nevojë për më shumë ndoshta, por të paktën tek qeto bursat u dashtë t'i shtimë edhe këta nxënës të cilët janë me nevoja të veçanta. Një e padrejtë por jo e sigurt, drejtor, kam dëgjue në bazë të arsimtarëve e po due ta dëgjoj nga ju. Arsimtarët të cilët mbajnë orë shtesë, disa arsimtarëve iu paguhen orët shtesë, e disave jo. A është kjo e vërtetë? Nuk kam të dhëna zyrtare, por vetëm po ta bëj një pyetje. Nëse po, mirë, nëse jo, është vetëm pyetje e mësuesve të

cilët më janë drejtue. Dhe një pyetje të fundit – pas këtij fjalimi ndoshta do të edhe fjalim tjetër. Kryetar, është përfolë bukur shumë në kohën e fundit, sidomos në këtë dimër, që patëm të reshurat e borës, jo u pastruan rrugët mirë, e jo s’u pastruan. Unë nuk e ndaj shumë mendimin me të tjerët, se rrugët nëpër fshatra kanë qenë mirë të punuara. Pavarësisht se politika nganjëherë thotë edhe jo – unë jam shumë i drejtpërdrejtë – nuk kanë qenë keq. Por ajo e keqja shumë e madhe e cila e lodhën edhe atë të fshatrave është: Dragashin ne e kemi qendër, qoftë administrative, qoftë politike, qoftë arsimore, qoftë shëndetësore e të gjitha. Janë të paktën 500 nxënës të cilët vijojnë mësimin në shkollën e mesme. Po edhe nja 100 e sa i kemi në shkollën fillore, 100 kemi mjekë, e nëpër Komunë e nëpër Gjykatë, kalon shifrën mbi 1000. Edhe pak hapësirë të trotuareve kemi, kryetar, 200 metre kemi trotuar prej Komunës deri të Stacioni i Autobusëve, njëra anë, edhe ana tjetër 100, 200 metre. A hiç s’ke plan veprimi që t’i pastrojmë këta trotuarët nga bora?! Pavarësisht që edhe reshjet po i kemi shumë të pakta këto vitet e fundit, por edhe pak borë që po bjer po bllokohen të gjithë trotuaret, po detyrohen qoftë të rriturit, qoftë fëmijët, nxënësit, të ecin nëpër rrugën kryesore. Përpos borës që është një element natyror, na edhe një pengesë shoqërore vetë po e krijojmë, kryetar. Këto vazot e luleve, sa po janë të mira gjatë verës, po na hieshojnë pak qytezën, por dimrit a nuk është e rrugës të largohen që po pengojnë edhe po e bllokojnë edhe qarkullimin e lirë të këmbësorëve. Ndoshta do të kyçem edhe pak më vonë, sa i përket këtij fillimi, kaq. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Do të filloj pak të diskutoj edhe unë për çështjen e bursave, edhe pse pothuajse në tërësi kolega im, profi Nexh, e rrumbullakësoi atë çfarë edhe unë pata të diskutoj. Por, një pjesë dua ta plotësoj dhe unë. Ne e dimë që zakonisht bursat jepen vetëm për studentët të cilët kryejnë studimet nëpër fakultete publike. Ndërsa ata që janë në fakultete private nuk kanë të drejtë të kandidojnë për ta marrë këtë ndihmë apo këtë shtytje që u jepet studentëve që në vitet në vazhdim të kenë rezultate edhe më të mira. Unë besoj që ata janë qytetarë të kësaj Komune, qytetarë të këtij shteti, janë taksapagues të kësaj Komune, të këtij shteti, dhe besoj që e meritojnë edhe ata që të jenë pjesë e listës së studentëve, nëse i plotësojnë kriteret. Natyrisht, ne e kemi atë mundësinë – ju si ekzekutiv, se neve nuk na lejohet si legjislativ – që t’i ndryshoni ndoshta edhe kriteret për studentët të cilët studimet i kryejnë nëpër fakultete private. Por, nuk është e drejtë që t’i privojmë në tërësi këta studentë, dhe mos të konsiderohen si banorë të shtetit të Kosovës. Tjetra, i nderuar kryetar, për të cilën deshta të diskutoj dhe që është diskutuar shumë në seancën e fundit, ka të bëjë me ato farë kositëset, mirëpo në fund, ju këtu në Asamble në lëshuet qatj njëfarë video dhe ne e pamë, por erdhi fundi që ne nuk arritëm ta kompletojmë çështjen, se çka ka ndodhë me

këto kositëset, me këtë projekt që bëri bujë të madhe ato ditë. Prandaj, unë po e kthej edhe një herë mbrapa, se dua të jam i qartë dhe ta kem të qartë çka ka ndodhë realisht me këto kositëse. Ato që ishin, në video që i pamë atë ditë që na u servuan nga ju, janë ende aty ku na i treguat atë ditë, apo e keni bërë shpërndarjen e tyre nëpër shkolla. Dhe tjetra çka po më intereson, çka do të bëni me ato kositëset që vetëm i keni dërgue në disa shkolla? I nderuar kryetar, tjetra për të cilën pata dëshirë të marr përgjigje nga ju – tash po bie në kundërshtim me kolegun tim, tha që rrugët janë pastrue shumë mirë nëpër fshatra. Vallahe në fshatin tim jo. Pastrimin e rrugëve në fshatin time e kanë krye, s’po them dy, po njëri nuk u ndalë, i shkreti, njëfarë bashkëfshatar i jemi, me traktor, prejse ka fillue bora deri në fund ai u marrë me rrugët. I kam pa të Komunës qaty, masi u përfundue mo procedura dhe rrugët kanë qenë të kalueshme, kanë ardhë pak i kanë shty ane-ane. Por, nuk mund të jap lëvdata që ka qenë si duhet dhe në rregull. Gjithashtu, një tjetër shqetësim sa i përket pastrimit të rrugëve, ka të bëjë me Emriun. Emria është i fshatit tim edhe është një superpunëtor, por pse kryetar e keni largue prej fshatit Kuk, ai po shkon diku tjetër po i hap rrugët. A nuk kish qenë më mirë të kish qenë ai në Kuk, Kosavë, Bresanë, t’i mbajë qeto fshatra që i ka afër, edhe banimin e ka afër, edhe punën mund ta kryente shumë më mirë dhe do të ishte gjendur afër këtyre fshatrave dhe rrugët do të kishin qenë shumë më të mira dhe shumë të pastruara më mirë, se që kanë qenë në këto reshjet e fundit të dëborës. Por për fat të keq, ai është në pastrimin e rrugëve nuk e di në cilën pjesë të Gorës, dhe mundësia e tij për t’i pastruar si duhet rrugët është pak më e vogël, në krahasim me atë që, po të kishte qenë në këto fshatra të cilat i potencova më herët. Shqetësimi i fundit i imi ka të bëjë me rrugën e cila është kubëzuar tash, kohët e fundit, javën e kaluar në fshatin Kuk. Nuk kam pas dëshirë fare që të merrem me këtë çështje, kaloj pothuajse çdo ditë aty, nuk e di me numër sa herë, edhe nuk a kam ba plan as që ta diskutoj, por patjetër më detyruan disa bashkëfshatarë që ta paraqes, që punimet të cilat janë kryer në atë rrugë nuk janë të duhura. Unë po e di gjendjen si ka qenë më herët, e di për shkak të emergjencës që ndoshta edhe punimet janë kryer ashtu siç janë kryer. Por, pasi që është dyvjeçar ky projekt, a mendoni ju që keni mundësi vitin e ardhshëm t’i bëni përmirësimet, ato çalime të cilat janë lejuje këtë vit, që vitin e ardhshëm t’i plotësoni dhe ta realizoni projektin si duhet. Apo kjo rrugë do të mbetet kështu, siç është finalizuar tani? Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Mu po më vjen keq, duhet me e pyet zyrtarin ligjor, më duket që nuk ka kuorum.

Samidin Xheladini: Kërkesë zyrtare bëj, prej këtij Kuvendi, për MAPL-në. Ju lutem, me na dhënë sqarime, derisa zgjat Kuvendi, kemi të drejtë të vazhdojmë seancën në qoftë se nuk ka kuorum, ose jo? Pasi që zyrtari ligjor nuk po na jep përgjigje. Të njëjtën praktikë jemi duke e bërë në vazhdimësi. Ju lutem, ju po bëni pyetje, përgjigjet zyrtarisht nuk po i merrni, për shkak se kryesuesja po e mbyll Kuvendin në mënyrën – unë mendoj – joligjore. Vendime nuk marrim na me shumicë votash, në qoftë se mungon kuorumi, por të drejtë diskutimi kemi deri të shterren të gjitha diskutimet dhe përfundon mbledhja. Kjo në vazhdimësi është duke na ndodhë. Ju lutem, ju po bëni pyetje, edhe ju vetë që po bëni pyetje nuk po i pritni përgjigjet edhe po shkoni. Opinioni po e dëgjon pyetjen, por përgjigjen nuk po e merr. Unë po due me e ditë përgjigjen e saktë, a është varianti i yt apo i tij i vërtetë. Unë jam shumë i stresuar nga kjo, në vazhdimësi po ndodh, edhe dikush po ua ndihmon këtë. Pyetja derisa të bëhet zyrtarisht, duhet ta presësh edhe përgjigjen ta marrësh.

Arijeta Skeraj: Atëherë, të dashur asambleistë dhe ju media, unë asnjëherë nuk e kam mbyll mbledhjen pa ndonjë shkas. Arsyeja e përfundimit të mbledhjes ka qenë gjithmonë kuorumi. Le të dalë ndonjëri që të thotë se e ka mbyllë Arijeta mbledhjen për diçka timen personale. Marre është me folë këso fjalë që nuk janë të vërteta. Unë absolut, qe sa e kam marrë mandastin, nuk e kam mbyllë mbledhjen e Asamblesë pr diçka tjetër, përveç se prej kuorumit. Unë e lus Televizionin Opoja, Radio Sharrin, që le ta vëzhgojnë situatën në Asamble, a është mungesa e kuorumit, apo unë po e ndërpres. E kisha lut që ta marrë fjalën zyrtari ligjor për këtë çështje, pasi që unë nuk e di mirë se si funksionon kjo pjesë.

Ademi Emini: Përsëritje, të nderum delegatë! Kuorumi duhe vetëm për atë pjesë kur duhet të merren vendime dhe ku duhet me votue. Ndërsa, diskutimet munden me vazhdue deri në përfundim, nuk ka rëndësi a ka kuorum a jo.

Arijeta Skeraj: Të lutem, z.Xheladini! Mundesh me pas personale me mu, po kështu nuk ta lejoj kurrë, jo ty por kërkujt hiç. Ti mua nuk mund të më tregosh se si ta mbylli mbledhjen. Si dua unë e bëj. Delegatë, ju që keni bërë pyetje, a doni me marrë përgjigje apo e lëni për në seancën tjetër? Kush është me e vazhdue seancën?

Artan Loshaj: Kryesuese, po më vjen keq një herë që të respektoj shumë për kolege, dy si kryesuese, edhe tre si bashkëvendase e imja. Unë e kam një pyetje për kryetarin – jam bo i tepërt – ndriçimi publik në fshatin Rrenc. Kanë qenë 20 mijë euro, ju kam thënë se nuk janë të mjaftueshme, kur e keni pa që është e vërtetë, atëherë e keni bo projekt dyvjeçar me 35 mijë euro,

ndërsa ata që e kanë marrë projektin kanë hy me 29 mijë euro e diçka. Më keni akuzue në mënyrën më të ulët të mundshme në fshatin Rrenc – ta kam thënë edhe dje, po për hir të qytetarëve, se janë t’u më shkruar mesazhe, nuk të kemi ngue dje, po dojnë me ngue qytetarët, se ta kam thënë unë ty – më keni akuzue, jo ju po ekzekutivi, shokët tu më kanë akuzue në mënyrën më të ulët të mundshme që unë me qëllim nuk ia kam çue një lagjes ose dy-tri familjeve ndriçimin. Ndriçimi, projekti është bërë në vitin 2020, por ai projekt nuk ka qenë final edhe nuk ka qenë në tender. Ju, nga mospuna juaj edhe nga koha e votave, delni në fshatin Rrenc edhe thoni projekti është i Artanit. Po, unë si asambleist e kam kërkue atë projekt, por unë nuk bëj projekte. Unë nuk jam inxhinier ose arkitekt, Doni me më ulë para qytetarëve, ata më njohin mu shumë mirë, jo që më ulni mu, po veç më rritni në katund. Një premtim e kam marrë prej drejtorit edhe prej menaxherit të projektit, që janë afër 15 shtylla tepër, edhe ato dy rrugët kryesore, kryetar – ta kam thënë edhe dje – Rruga “Kroi i Balisë” – kryesuesja është prej fshatit, nashta me rrugë nuk i di se jeton në Prizren – është rrugë kryesore, të gjitha ma të moshuarit kush janë e dinë atë rrugën Opoja-Rrenc-Shajne-Dragash. Nuk është në projekt. Rruga tjetër, që kemi shti qindra e mijëra euro, prej te Molla e Kuqe e deri te Gurishta, edhe ajo rrugë është kryesore, edhe ajo rrugë nuk është në projekt. Kemi mund ne me gabue, si PDK edhe si Artan, nuk e them që jo, por thashë edhe një herë, ai projekt nuk ka qenë final edhe nuk ka qenë në tender. Ju, për mospunën e juaj, nuk e keni bo një rishqyrtim, se keni ardhë ju kuse dini ma mirë me udhëheq, neve n aka dënue qytetari, jemi në opozitë, tash që tri vite ju keni marrë projektin e 2020-tës, për dy-tri a pesë vota, a dhjetë vota që mundeni me i kap në Rrenc, keni marrë qat projekt, copy-paste, të vitit 2020, edhe e keni qit në tender. Është e pafalshme! Më është premtue, pa parti, pa politikë, se ata qytetarë janë taksapagues të Komunës, nuk janë paret e Komunës ose të xhepit të juaj, ato pare janë të taksapaguesve, të të gjithë qytetarëve. Edhe më është premtue, në qoftë se nuk bëni pengesë, sot qe po dal publike me e bo këtë, më është premtue që do të bëhet përmirësimi, edhe deri në përfundim të projektit i gjithë fshati do të ketë ndriçim publik, e sidomos rrugët kryesore ku e meritojnë. E dyta, kryetar, ju kujtohet shumë mirë që në Komitet unë jam pak më i zëshëm, ta kam bo një kërkesë edhe në Komitet, ta kam bo një kërkesë edhe në seancë, që kam lyp zyrtarisht nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, harxhimet prej muajit janar deri në shtator 2024, si dhe listën e subvencioneve për të riatdhesuarit brenda periudhës 2021-2024 në Komunën e Dragashit. Zyrtari për Komunitete dhe Kthim, bosi i bosave, i ledhatumi juaj – veç para se me fillue, e dinë qytetarët e Gorës që unë jam njeri më tolerant ndaj gjuhëve edhe e foli 90% gjuhën e tyre. Tash, mos të ma marrin për të keq që

unë po due me i neglizhues këta edhe me i përbuzë, por zyrtarisht ky i nderumi ma ka kthye në gjuhën serbe ose boshnjake. Gjuhë zyrtare e imja është gjuha shqipe, gjuha nënës time edhe e krejt nënave tona. Nuk jam unë kundër minoritetit, këta le ta folin secili gjuhën e vet edhe jau respektoj maksimalisht. Njeri ma tolerant jam, e di mirë edhe Uzairi. Ama kjo është zyrtare, nuk ia toleroj, kryetar, edhe kërkoj nga ju që të merrni masa dhe bare së paku të delni këtu edhe ta dënoni këtë akt qyqar të këtij zyrtari. Pa marrë parasysh, se këtë e ka bo ky me qëllim, se ma di temperamentin, edhe kur t'ia çoj unë këtij në gjuhën serbe ose boshnjake, ky nuk do të del në foltore. Unë kam dalë në foltore, këtë e kam përkthye unë, edhe ky më ka kthye përgjigje që për harxhimet janar – shtator e paska një buxhet 25 mijë euro. Afër 19 mijë euro paska paga dhe shtesa, ndërsa mallra dhe shërbime i ka 6 mijë euro. Mu po më vjen çudi – ta kam thënë edhe dje, ta dëgjojnë edhe qytetarët, sidomos të komunitetit goran/boshnjak – që i nderumi për nëntë muaj ditë 7 herë ka bo mirëmbajtjen e teknologjisë informative, me vlerë afër 570 euro. Unë e di që z.Basri Gashi është mbikëqyrës i IT-së. Nuk po e kuptoj unë ky pse, qaq shumë që rri në zyrë, qaq shumë që punon, 7 herë për 9 muaj ditë është prish kompjuteri apo pajisjet. E dyta, kryetar, ky i nderumi ka bo harxhime me karburant 1491 euro. Unë e di që ky e ka një kerr me tabela zyrtare edhe që e keqpërdor. Unë bisedoj me kryetarin e Komunës, ky është punëtori yt – ose edhe me shefin, që shefi është t'u ngue, po unë kam marak me kryetarin direkt, me drejtora e me këta tjerët kur s'je ti këtu. Për këtë çështje unë kam shkue të kam kërkue në zyrë. Në zyrë nuk ke qenë, ke qenë jashtë shtetit, privatisht a zyrtarisht, nuk më intereson. Kam shkue të nënkryetari, e kam takue edhe kryesuesen, edhe i kam thënë pse ky provokim edhe kjo neglizhencë ndaj meje, pse ka ndodhë kjo. “Do ta përmirësojmë këtë ganimin”, gabimin nuk e kanë përmirësue, nuk më kanë pru dokument tjetër. Mu më intereson një send, qat kerrin që e menaxhon zyrtari për komunitete, 24 orë e merr, që e ka ilegalisht atë. Edhe, deri më sot unë e kam ditë që vozit kerr të vogël, tash po duhet me e pyet mos vozit naj autobus ose naj kamion të madh, qysh iu thojnë atyre, 14 mijë kubik, për arsye se më 08.03.2024 në HIB Petrol, karburante për veturë 127 euro. S'e di një kerr i Komunës 127 euro që mundesh full me e mbush. S'po e kuptoj unë. Ose ky, kur e kam kërkue këtë, ka shkue ka mbledhë fatura edhe i ka pru ato faturat. Më 25.03.2024 200 euro ka qit karburant. Me siguri autobusi, s'po e kuptoj, ose mos e ka ndonjë avion privat ky. Ma poshtë shkojmë: HIB Petrol 285 euro, kamioni me dy prokolica. Ma poshtë shkojmë, kryetar, nuk e kam kuptue, kam qef me m'dhënë informatë, avans 500 euro i paska pas, pare t'ima në xhep me iu gjet. S'janë kurgjo 500 euro me i pas në xhep ai, për kafe. Problemin tjetër, që e kam kërkue listën e subvencioneve për të

riatdhesuarit. Ai e di ku e kam unë edhe për kënd bëhet fjalë, për cilin person edhe për cilin person ia kam kërkuar. E di ky për kënd e kam fjalën, kujt i ka bo renovim edhe kujt i ka dhënë subvencione. Edhe ky ma jep në gjuhën e vet, në gjuhën boshnjake, ma jep që Zyra për Komunitete nuk bën subvencionime. Unë javën e kaluar, kur erdha me marrë informata, e gjeta zotninë me një qytetare t'u e marrë me e lajmëruar që i riatdhesuari duhet në Komunë seftë, në Zyrën për Kthim me u regjistruar, e pastaj me aplikuar në ministri për subvencione. Ky i nderumi thotë vallahe jo bre sunë s'kam buxhet, kah ana tjerër merr gurthemelin e vë me kryetarin dhe me Ministrin Rashiq a qysh ke. Kne thotë s'kam subvencione, s'di unë, a kne kur duhet me marrë poena politike, del thotë na e vumë gurthemelin. Masnej, më 27 nëntor del edhe çelësat i dorëzon ky. A kne thotë s'e kam listën. Qytetari që vjen – po jo krejtve, ata që e mbështesin këtë edhe partinë e tij, edhe ju bëj apel – po s'janë sot minoriteti këtu, duhet urgjentisht këtë me e shkarkuar. Unë po çuditë pse minoriteti qaq ia kanë frikën këtij. Se ky nuk e përfaqëson komunitetin. Aty duhet me qenë i pavarur. Ky i përfaqëson veç një grusht njerëzish që mbështetin partinë e tij në të cilën rri nën hije, edhe partinë e Duda Baljes. Edhe kërkoj nga kryetari edhe krejt partitë politike që ky duhet me u shkarkuar. Edhe herave tjera, kur të t'lypim, bonu ma i singert për dokumentacion, se më njohish shumë mirë mu. Edhe unë nuk do të heshti, prapë do ta lyp listën për ata persona të cilët janë të riatdhesuar për tri vite edhe që i regjistrojnë në Zyrën për Kthim. Edhe do ta lyp listën – në qoftë se ka nevojë edhe në ministri – e dish shumë mirë, edhe një herë po të them, për kënd e kam fjalën, ma mirë bonu i singert. Jashtë me m'pas thënë, mos bre mos më provoke brenda, se jemi shokë na, jemi konë shokë edhe prapë kemi m'u konë shokë, po zyrtarisht jo. Zyrtarisht, s'po due me u lëshuar, po më vjen keq, se unë jetoj me ju, unë e foli gjuhën e juaj edhe ju respektoj ma shumë se ti vetveten. Nuk po due me u lëshuar unë me ty, se në seancën tjetër, në qoftë se nuk ma jep qat listën, unë zyrtarisht, me datë, me sekonda, me minuta, të kallxoj cilin njeri të padëshirueshëm të Komunës së Dragashit edhe të Republikës së Kosovës e keni subvencionuar. Faleminderit!

Driton Ademi: Atëherë, disa pyetje për kryetarin, masi veç kryetari paska mbet, edhe drejtori qenka i Arsimit. Kryetar, para disa muajve kam kërkuar për me i vu mashat e borës te salla e sporteve. Siç ka ndodhë me borën e kaluar që ka ra, është mirë se ata e kanë vu vetëm një rend masha. Edhe me borën kaluar aty ka mund me i zënë nxënës. Është mirë me u marrë me më të çështje, se kjo çështje po e lidh çështjen tjetër. Po e lidh çerdhen. Hyrja e çerdhes – në bazë të projektit që e kam pa – është bash me atë pjesën e kundërt. Te pjesa e çerdhes, kryetar, a s'patët kund ku me e bo çerdhen po qaty, a? Me ngulfat oborrin e shkollës. Veç më kallxo edhe del

publikisht prano, thuj që unë kam bo diçka për arsimin. Për sa vjet je në politikë, qe 25 vjet. Edhe për sportin si të ke bo naj send, unë ta jap dorën. Kurrë nuk ke bo, prej masi jemi çlirue, 1999-2024, kurrë nuk ke bo, asnjë send s'ke bo. Ty të duket se nashta unë munda mos me pa ose mos me ndie, po qytetarët shohin edhe ndijnë shumë mirë. Kryetar, në kohë bash të borës, ke bo renovimin e shkollës. Pse bëhet dy pjesë renovimi i shkollës, edhe kur është ma ftohët. Zvogëlohen orët, ku kanë me shkue ata nxënës që javën tjetër kanë me shkue në pushim dimëror. Edhe e ke bo një kërkesë për kryetarët e fshatrave për pagesën e rrymës, mos gabofsha. Një njoftim e ke bo për me i takue kryetarët e fshatrave për pagesën e ndriçimit publik. Një pyetje e kam: si do ta bëshë zgjidhjen te disa fshatra të cilët dritat i kanë të lidhura nëpër oborre, nëpër shtëpia të tyre. Qekjo është një kërkesë e disa qytetarëve që e kanë rrymën nëpër shpia të veta. E di shumë mirë kryetari, Blaçi, Zgatar dhe disa fshatra janë të cilët kanë më hy në sistem që i ka kërkuë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër prej asambleistëve me e marrë fjalën? Para se me e marrë fjalën z.Xheladini, Artan, a po duesh Uzairi me t'u përgjigj për pyejtet, apo kryetari? Okej, atëherë jemi në rregull, Uzairi të përgjigjet.

Samidin Xheladini: Unë personalisht nuk kam punë më askënd, kush ka personale qe ku jem. Këtu përherë kanë qenë zyrtare edhe shtetërore, edhe ligjore, e personale qe ku jam, kur të doni e çka të doni. Ju delegatë, për ju po më vjen keq kolegët e mi, se na këtu jemi të zgjedhurit e popullit. Unë s'ka asgjë personale, mu më është mohuar e drejta me diskutue e krejt, po nuk është problem ajo. Shumica këtu e keqpërdorin pozitën, pse është vëllai im kryetar i Komunës, edhe unë nuk munda me e ushtruar detyrën e asambleistit ashtu si duhet. Edhe një herë po e përsëris, po e keqpërdorin disa njerëz edhe disa zyrtarë, po e keqpërdorin postin e kryetarit të Komunës pse e kam vëlla unë, edhe nuk po më lejojnë mu me e krye detyrën e asambleistit qysh duhet. Dhe, një prej atyre që nuk më ka lejue dhe në vazhdimësi më injoron është edhe kryesuesja. Shumë herë unë e kam kërkuë fjalën me dalë me diskutue, nuk ma ka dhënë, sa që më ka detyrue me dalë jashtë vetes edhe me folë prej vendit. Sepse më është ndaluar e drejta mu me diskutue këtu në foltore. Edhe kam dalë jashtë rregullave, për hir që më është mohuar e drejta me diskutue. Shumë raste kam pas që nuk m'u dhënë mu fjala, iu dhënë të tjerëve padrejtësisht, në mënyrë joligjore, duke e shkelë Statutin. Unë nuk kam reague, po kam hesht, derisa mu nuk më është dhënë. Nuk kam kurgjo personale me askënd, 100 herë kam kërkuë, pikërisht më ka pengue mu në vazhdimësi, edhe kur ka qenë Urani, shkelja e Rregullores. Na vetë po e shkelim Rregulloren, edhe kur po na konvenon po e zbatojmë, kur s'po na konvenon po e shkelim. Aq më keq kur është prej kryesuesit,

ose prej kryesueses, kur shkilet ajo është – ose zëvendëskryesuesit, edhe ai e shkelë Rregulloren. Tash unë mend nuk kam nevojë me ju shit juve, as me ju kallxue, por po due me thënë që ne duhet të jemi shumë transparentë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe të përgjegjshëm para qytetarëve. Në atë masa sa kemi mundësi, se normal që s’jemi na jashtëtokësorë e me mbërri gjithçka. Në vazhdimësi ka pas pyetje në pikën e ndryshme, ka pas pyetje zyrtare prej delegatëve të cilët të gjithë pyetjet i kanë bo me vend. Kemi të drejtë me pyet, me diskutue, edhe përgjigjen duhet me e marrë zyrtare. Por, në qoftë se përgjigjja nuk është zyrtare, duhet ta lypim na, ta kërkojmë me ngulm edhe me shkrim. Në qoftë se nuk na jepet në këtë seancë, në seancën e ardhshme me shkrim. Kjo është forma më e mirë, për mos me e lajthit opinionin. Ne të gjithë duhet ta respektojmë dhe t’i frikësohemi ligjit. Unë po kërkoj prej jush, të nderuar delegatë, që gjithmonë seanca, mundësisht me vazhdue deri në fund. Unë e kam pa një tendencë – ju nashta s’e keni pa – se pyetjet janë bo këtu, kur ka ardhë puna me marrë përgjigje, kryesuesja e ka ndërprerë mbledhjen. Tri herë radhazi e ka ndërprerë seancën në mungesë të kuoromit. Kjo është shkelje e rëndë. Si nga ata të cilët kanë bërë pyetje dhe kanë dalë jashtë, si nga ana e kryesueses e cila nuk ka kërkuar prej drejtorëve, zyrtarëve edhe kryetarit, me dhënë përgjigjen adekuate, edhe dy persona në qoftë se janë në sallë. Është mbledhja publike dhe e kanë dëgjuar pyetjen, ndërsa përgjigjen nuk e kanë marrë. Mu po më intereson e vërteta, unë nuk po due t’ia mbaj anën as pozitës, as opozitës. Po due të vërtetën me e ditë si është.

Uzair Hamza: Pershendetje te gjithëve. Më vjen keq që delegatët nuk më lanë të flas pak më parë, edhe pse kishte të bënte me çështjen e mbrojtjes së pakicave. Doja të flisja për një gjë të rëndësishme, që është që me vendim të kryetarit të komunës emërohet një person nga një komunitet joshumicë në QKMF, në mënyrë që diskriminimi që vjen nga niveli qendror të jetë i balancuar. Jam këtu për t’iu përgjigjur pyetjeve që më ka bërë si drejtues i Zyrës nga Artan Loshaj. Në fillim do të doja të kërkoja falje për gabimin teknik që ndodhi gjatë dërgimit të dokumentit. Unë e di ligjin, megjithëse dokumenti është dërguar në shqip, e kam përkthyer dokumentin dhe jam përgjigjur, por jo për të provokuar delegatin, nuk kam asgjë personale me të. Për arsye teknike nuk kam mundur të përgjigjem në gjuhën e tij siç e kërkon ligji, që kërkon përgjigje në gjuhën e palës. Deklarata ime është dëshmi se nuk kam asgjë personale kundër tij. Marr shumë e-maile nga institucionet qendrore, të cilat janë ekskluzivisht në gjuhën shqipe dhe nuk kam thënë kurrë se është provokim. Meqenëse pyetja është shumë e ndjeshme, unë do t’u përgjigjem pyetjeve me

radhë. Kërkesa në vetvete nuk ishte e formuluar mirë. Kërkesa kërkon subvencione. Nuk e di nëse është përkthyer mirë, por vërtet nuk po provokoja, por nuk kemi subvencione.

Buxheti ynë është 28.000 euro, pagat, mallrat dhe shërbimet janë vetëm 6.000 euro. Pra, bazuar në UA 2/2010, dhe UA lidhur me kthimin e personave të zhvendosur, kemi të bëjmë me kthim. Ekziston një procedurë specifike ku të kthyerit regjistrohen në bazën e të dhënave dhe ne kemi gjithashtu një dokument në të cilin angazhohemi për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave. Në nivel komunal ekziston një komision i formuar nga kryetari dhe ekziston që nga hyrja në fuqi e Rregullores, kur kryetar ishte Shaban Shabani. Ky komision ka 8 anëtarë dhe sipas Rregullores, drejtuesi i zyrës është kryetar i komisionit. Pra, ne nuk bëjmë asgjë me qëllim. Të kthyerit regjistrohen tek ne. Ne vizitojmë të kthyerit. Pas kësaj, caktojmë një takim të grupit punues me 8 anëtarë, një anëtar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, anëtarët e tjerë janë: përfaqësues e arsimit, shëndetësisë, punës dhe mirëqenies sociale, përfaqësues të grave, planifikimit dhe urbanizmit, një anëtar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Ky është ky Vendim. Në bazë të këtij Vendimi, ne rekomandojmë se për kë do të ndërtohet shtëpia, ndërsa në nivel të Kosovës ekziston një komision që e jep fjalën përfundimtare dhe miraton apo nuk miraton. Keto 6 shtëpite që po ndertojme tani janë miratuar në vitin 2013, nga lista që është miratuar atëherë, sigurisht unë nuk kam qene shef i zyrës në atë kohë, ajo liste konfirmojmë vazhdimisht deri në momentin që na vendosi ministria në projektin RRRK 6, dhe me këtë u bëmë përfitues të ndihmës nga ajo listë. Për pyetjen për përdorimin e parave, kolegu im nuk e ka kuptuar mirë, bëhet fjalë për karburantin që paguhet në baza mujore. Kjo mund të verifikohet lehtësisht. Sa i përket riparimit të kompjuterit, ne kemi 2 zyra, i kemi paguar riparimet punonjësve të tjerë dhe unë si shef i zyrës nuk kam marrë asnjë cent nga teprica nga Petty Cash, përveç 20 eurove, madje edhe mjete janë përdorur nga zyra jonë dhe nga drejtoritë e tjera. Kjo mund të kontrollohet shumë lehtë.

Nuk jam i obliguar t'i përgjigjem pyetjes së subvencioneve, por nuk do të doja të ishte e paqartë kur është fjala për pyetjen se kujt i ndërtuam shtëpitë, cilët persona të dyshimtë, të cilët ndodhen sot në prokurori ku është nisur një procedurë për kryerjen e veprave penale ose krimeve kundër civilëve. Ju si delegatë keni të drejtë të shikoni dokumentet, ata nuk janë të kthyer të rregullt, këta të kthyer janë kthyer përmes Këshillit Danez për Refugjatët. Këtu kemi një memorandum të nënshkruar ndërmjet Këshillit Danez për Refugjatët dhe Komunës së Dragashit. Ky memorandum është nënshkruar nga kryetari i atëhershëm Salim Jenuzi, është bërë ndërrimi i kryetarit, pastaj është nënshkruar memorandum i dytë, i cili është nënshkruar nga kryetari i ri Shaban Shabani.

Këshilli Danez për Refugjatët rindërtoi 4 shtëpi, duke përfshirë një nga ata që akuzohej për krime lufte kundër civilëve, pasi ishte polic. Dokumentet e tij janë këtu. Pra, ne si komunë e kemi ndjekur memorandumin që është nënshkruar. Askush nuk e dinte, personi e kalonte kufirin normalisht, duke ardhur e duke u kthyer. Në vitin 2017 ka nënshkruar, më 14 maj 2018 ka nënshkruar ku thuhet se i është rikonstruktuar shtëpia, jo ndërtimi i një shtëpie të re, por rikonstruksioni është bërë në bazë të një memorandumit. Ashtu siç kemi sot një memorandum bashkë me IOM-in dhe Advance together, të cilin e nënshkruan kryetari i komunës, unë isha koordinator në atë kohë. Tani shtrohet pyetja, “pse bëhëm budall kur vendos gurthemelin”. Lind pyetja se si marr pjesë ndonjëherë dhe ndonjëherë jo? E përsëris, ne propozojmë, e kur të përfundojë projekti, ky është një dokument që shefi i zyrës nënshkruan se puna ka përfunduar sipas procedurave.

Projekti këtu zbatohet nga IOM dhe financohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Nënshkrimi im është këtu kur konstatoj se objekti është në rregull dhe se puna ndërtimore është në përputhje me ligjin. Nëse ka ndonjë paqartësi, jeni të mirëpritur të vini në zyrë për çdo pyetje, kë ndihmojmë, si ndihmojmë. Këtu është dokumenti që kemi nënshkruar për konfidencialitetin. Kjo është një listë e shtëpive që kemi ndërtuar për njerëzit që janë miratuar në 2013. Shtëpia është ndërtuar për personin që ishte përmendur kur unë nuk isha shef i zyrës, por vetëm koordinator. Vezaip u mor me kthimin. Memorandumi u zbatua në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar nga kryetari i komunës në atë kohë. Nuk dua të glorifikohem për asgjë, nuk ka asnjë formë provokimi, nuk kam pasur kurrë probleme me Artanin personalisht, madje jemi shoqëruar, vetëm dua të them që punojmë në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren. Unë thashë për kompjuterët, me laptopë kemi 7 kompjuterë, mund të jetë shumë e lehtë të kontrollojmë se kush dhe si është paguar nga buxheti ynë. Ndonjëherë buxheti ynë paguan një drejtor tjetër dhe anasjelltas.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Besoj se Artani ishte i kënaqur me përgjigjen. Atëherë, i nderuar kryetar, ata që t’i kanë bërë pyetjet nuk janë në sallë, a doni ju t’u përgjigjeni pyetjeve?

Bexhet Xheladini: Atëherë, sa u përket simboleve, është e vërtetë që për 28 Nëntor kanë qenë të vendosura në të gjithë qytetin por në Komunë jo. Kështu që, kur ne e kemi hetuar që nuk janë, i kemi vendos me vonesë. Sa i përket furnizimit me dru, unë po e them atë që po e lexoj, ky ka qenë një reagim i partisë së tij, i PDK-së, të cilët kanë shprehë një dyshim se nuk po mbahet mësimi, klasët janë të ftohta, nuk ka dru. Me ta para unë këtë reagim të PDK-së, menjëherë e kam formuar një komision prej nënkryetarit, drejtorit të Arsimit dhe një zyrtar tjetër, dhe i kam urdhëruar që t’i vizitojnë të gjitha shkollat dhe paralelet e ndara. Ditën e nesërme këta zyrtarë i kanë vizituar të

gjitha shkollat, dhe kanë konstatuar, kanë pru raport se në të gjitha shkollat është mbajtur mësimi, në të gjitha shkollat është dhezë nxemja, dhe ka pas e ka dru të mjaftueshme nga viti i kaluar. Arsyeja pse kemi ne dru nga viti i kaluar është sepse ne, kur e bëjmë porositë dhe pranimin e druve, i pranojmë ashtu siç i kemi porosit, edhe kualitetin edhe sasinë. Për atë, ne kemi edhe një muaj dru nga viti i kaluar. Kështu që, shkollat në asnjë moment nuk kanë ngelur pa dru, përveç një ditë që shkolla fillore në Dragash, si pasojë e avarisë së kalldajës nuk ka pas nxemje, por atë natë në mbrëmje ne e kemi rregulluar dhe nesër nxemja u lëshuar. Kjo ka qenë një avari e cila nuk është varë nga ne, nuk jemi evlë që me e ditë që do të ndodhë ajo avari. Sa u përket bursave të studentëve, ne kemi vazhduar me dhënien e bursave për student dhe 95% e të gjithë atyre që kanë konkurruar kanë fituar bursë. Ekziston edhe Komisioni për Ankesa, ata të cilët janë të pakënaqur, Komisioni ka me i shqyrtuar ankesat dhe nëse vërteton se ka ndonjë lëshim nga Komisioni për Vlerësimin e Dhënies së Bursave, atëherë ky Komision ka me e përmirësuar atë gabim. Ne bursat i ndajmë sipas Rregullores të cilën ne e kemi gjet, dhe këtë Rregullore e kanë bërë ata të cilët tash po lypin ne me e shkelë. PDK-ja, pushteti i kaluar e ka pru këtë Rregullore dhe ne jemi duke e zbatuar këtë Rregullore pikë për pikë. Gjithashtu, në atë Rregullore shkruan se ata të cilët marrin bursa nga Universiteti i Prishtinës, ata nuk kanë të drejtë të marrin bursë nga Komuna e Dragashit. Sepse edhe ato mjetet që i marrin atje janë mjetet e taksapaguesve kosovarë, edhe këto janë. Gjithashtu, u tha se po largohen studentët të cilët e kanë notën mesatare mbi 9. Në Rregullore nuk shkruan që ata të cilët e kanë notën mesatare mbi 9 kanë të drejtë me marrë bursa. Për pesë fëmijët me nevoja të veçanta, prej se jam unë kryetar, ne për çdo vit ua bëjmë pagesën e shpenzimeve të udhëtimit të gjithë atyre të cilët udhëtojnë për Prizren dhe për Pejë. Për orët shtesë – ndoshta fol edhe Drejtori Zeniu – por jo me fajin tonë, me fajin e Qeverisë dy muaj mjete nuk ka pas. Është rrezikuar arsimi të mbetet pa paga, andaj ato pagesat janë vonuar. Këtë muaj e kemi bërë thuajse më shumë se gjysmën e pagesave, në muajin janar do t'i kryejmë të gjitha pagesat e orëve shtesë. Kështu që, ne askujt nuk do t'i mbetemi borxh. Për pastrimin e rrugëve, e di që ka qenë ekselente edhe nuk due me u lëshuar më shumë. Për vazot, është gabimi ynë, jo i yni por i fituesit të tenderit, i na ndodhur përdje një vdekje në familje, kështu që ditët në vijim ato vazo do të hiqen. Gjithashtu, u kërkua që me iu dhënë bursa edhe studentëve të cilët studiojnë nëpër universitete private. Edhe atë Rregullorja nuk ua lejon. Për kositëset e barit, ne atë ditë në seancën e kaluar e kemi bo edhe videon, ata të cilët nuk besojnë munden lirisht me shkue edhe me i pa në depo, kositëset janë aty. Edhe kjo lëndë ka qenë në prokurori, e kanë çue këta – mirë që e kanë çue – u sqarue, prokuroria

e ka pa që është një informatë e gabuar edhe nuk ka kurgjo prej kësaj. Çka është me rëndësi, ne si qeveri komunale, që tri vite që jemi, nuk kemi asnjë aktakuzë, asnjë të dënuar, asnjë rast korrupsioni dhe asnjë tender njëburimor. Derisa komunat tjera kanë tendera njëburimorë, që tri vite të qeverisjes së LDK-së, bashkë me koalicionin, nuk kemi as edhe njëburimor. Kjo është për çdo lëvdatë, edhe prej kryetarit, edhe prej Asamblesë, edhe prej stafit që punon në Komunën e Dragashit. Rruga në fshatin Kuk ende nuk ka përfunduar, është projekt dyvjeçar, aty vazhdohet të punohet dhe Komisioni për pranim nuk do t'i pranojë punimet të cilat nuk janë kualitative dhe nuk janë në bazë të tenderit që janë shpallë. Për Emriun, pse u largue nga fshati, Emriu është një traktorist shumë me përvojë edhe atij ia kemi dhënë terrenet më të rrezikshme, ia kemi dhënë Xërxën, Pllajnikun, Radeshën, Brodin, sepse këta vozitësit tjerë e kanë një përvojë pak më të vogël, ky sigurisht 40 vjet e ma shumë ka përvojë me traktor. Ndriçimi publik në fshatin Rrenc, ju jeni të gjithë dëshmitarë që zotëriu me dhjetëra herë ka kërkuar që të bëhet ndriçimi i fshatit Rrenc – ekziston projekto, ekziston projekti – ka thënë unë e kam bo, tash po thotë unë s'e kam bo. Projekti është bërë me tender nga qeveria e kaluar, edhe qëllimshëm janë lënë disa rrugë ku banojnë njerëzit e partive tjera. Edhe tash ne, kur kemi nis me e bo implementimin e këtij projekti, kemi vërejt se disa rrugë kryesore i kanë lënë me qëllim. Mirëpo ne këtë padrejtësi e kemi rregullue dhe e kemi bo ndriçimin edhe të atyre rrugëve. Ky është projekt dyvjeçar dhe deri në fund ne do ta përfundojmë, i gjithë fshati ka me pas ndriçim publik. Sa u përket pyetjeve për Zyrën e Komuniteteve dhe Kthimit, atë ju dha përgjigje Uzairi, por duhet ta dini që për pyetjet që janë bo sa u përket shtëpive, Uzair Hamza atëherë nuk ka qenë shef, ka qenë Mehmet Hamza, ndërsa memorandumet i kanë nënshkrue dy ish-kryetarët e zotëriut i cili ka ngrit pluhur pa nevojë. Gjithashtu, u përmend Petikeshi 500 euro, Uzairi është zyrtari i cili asnjëherë nuk e harxhon buxhetin. Gjithmonë në fund, gjysma e buxhetit mbetet pa harxhue. Mirëpo ne, kur e shohim që ka buxhet në zyrën e tij, atëherë shumë fatura ne kemi bo pagesë nga buxheti i tij, por nuk janë ato shpenzime të Zyrës së Komuniteteve. Gjithashtu edhe Petikeshin 500 euro e kanë shfrytëzue krejt punëtorët e Komunës, ndërsa mjetet janë marrë nga Uzair Hamza. Kështu që, nuk mund ta akuzojmë atë se e ka shfrytëzue Petikeshin. Për mbrojtëset e borës, i kemi vendos po ai s'i ka pa. Renovimi i shkollës në dy pjesë, po është e vërtetë, herën e parë e kemi bo renovimin e katit të naltë të shkollës. Arsyeja pse s'e kemi bo edhe katin e poshtë është se nuk kemi pas mjete, por në fund të vitit, kur e kemi pa që na kanë mbet mjete, e kemi bo edhe renovimin e katit poshtë. Lidhur me atë njoftimin që e kemi bo na si Komunë për pagesën e rrymës, kemi kërkuar nga kryetarët dhe

këshilltarët e fshatrave, ta gjitha fshatrat të cilat kanë të instaluar ndriçimin publik me orë – jo që e kanë të lidhur nëpër shtëpi – t’i bien kërkesën dhe pagesën zero-zero deri në muajin janar. Këtë e kemi bërë sepse kjo është forma më e lehtë, një herë me ua krye punën këtyre të cilët janë duke e paguar privatisht. Pastaj, pasi të kryhen këto, do t’i lëshohemi edhe asaj pjesës tjetër, të cilët e kanë edhe me solarë edhe ata të cilët e kanë të lidhur nëpër shtëpia, edhe për ta do të gjejmë një zgjidhje. Do të bëhet një lidhje e përgjithshme, do të vendosen orët, edhe pastaj do të fillojë pagesa. Unë besoj se iu përgjigja të gjitha pyetjeve, edhe në fund nëse kam lënë diçka pa përgjigj, e kisha lut Zeniun me m’plotësue edhe po e përfundojmë.

Zeni Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse pyetjet që u parashtruan në drejtim të DKA- së, të gjitha pyetjeve gati iu është përgjigj kryetari, mirëpo unë e shoh një joseriozitet të delegatit të Kuvendit, ai edhe në seancën e kaluar ka ardhë me atë frustrimin e vet, duke na dhënë edhe neve grada si superdrejtor. Në Arsim janë duke vijuar punët siç është më së miri, në prag të përfundimit të gjysmëvjetorit, nuk kemi pas asnjë pengesë deri tash edhe asnjë ngecje. Përndryshe, si drejtor i DKA-së unë jam i gatshëm të jap përgjigje gjithmonë për pyetjet që parashtrohen në seancë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! E mbyllim këtë seancë! Shihemi më 2025!

 Kryesuesja e Kuvendit
A. Skeraj
Arijeta Skeraj